

STUDIM MBI VLERËSIMIN E AKSESIT TË SHTRESAVE NË NEVOJË NË FORMIMIN PROFESIONAL

Ky studim u realizua nga Qendra Europiane me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, nëpërmjet financimit të Qeverisë së Republikës së Italisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

i. Lista e Akronimeve dhe Shkurtimeve

ii. Lista e grafikëve

I. Përmbledhje Ekzekutive

II. Metodologjia

III. Kuadri ligjor dhe institucional për masat kundër trafikimit të personave – në fokus mbrojtja e fëmijëve

IV. Kuadri ligjor dhe institucional i Arsmit dhe Formimit Profesional në Shqipëri

V. Gjetjet kryesore të studimit të nevojave

VI. Rekomandime

Shtojcat

Falënderime

Ky botim u realizua nga Qendra Europiane dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të projektit “Mbrotjtja e fëmijëve dhe të miturve nga trafikimi dhe shfrytëzimi”, i financuar nga Qeveria e Italisë.

Qendra Europiane dëshiron të shprehë falënderimet e saj ndaj të gjithë atyre, që kontribuan në përgatitjen e studimit mbi vlerësimin e aksesit të shtresave në nevojë në arsimin formimin profesional si një astet i vlefshëm për orientimin ndaj tregut të punës dhe shmangien e migracionit të pasigurt. Mirënjohje e veçantë i takon Znj. Juliana Rexha, Këshilltare për Anti-Trafikimin, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri për këshillimin dhe mbështetjen gjatë gjithë fazave të realizimit të këtij studimi.

Mbështetja nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Shkollat 9-vjeçare, Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik, Zyrat Rajonale të Punësimit, Njësitë për Mbrotjtjen e Fëmijëve, Agjencitë Private të Punësimit dhe Qendrat Private të Formimit Profesional në pesë bashkitë e përcaktuara sipas projektit¹, ishin një kontribut i çmuar pa të cilin nuk do të ishte bërë e mundur përgatitja e këtij studimi.

¹ Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër

Shkurtime & Akronime

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AFPP	Arsimi për Formim Profesional Publik
AFPPr	Arsimi për Formim Profesional Privat
AMP	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
DAR	Drejtori Arsimore Rajonale
DDF	Deklarata për të Drejtat e Fëmijës, OKB, 1959
DPSS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020
DSHSB	Drejtorja e Shërbimit Social pranë Bashkisë
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, OKB, 1948
KDTHBE	Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, 2000
KE	Këshilli Evropian
KEDF	Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Femijëve, 1996
KEDNJ	Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, KiE, 1950
KiE	Këshilli i Evropës
KP	Kodi i Punës, Ligj nr 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar
Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligj nr.8417, datë 21.10.1998
LAFP	Ligj “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH, nr.15/2017
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONP (ILO)	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OSCE PiA	Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civil dhe Politike, OKB, 1966
PNDESK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, OKB 1966
PVLKTP	Plani i Veprimit të Luftës Kundër Trafikimit të Personave 2014-2017
QE	Qendra Evropiane
SBE	Strategjia e Bashkimit Evropian
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020
SLKTP	Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave 2014-2017
ZVP	Zyra Vendore e Punësimit

Lista e figurave

- Figura nr. 1:** Perspektiva gjinore e të anketuarve
- Figura nr. 2:** Përqindja e të anketuarve në secilën Bashki
- Figura nr. 3:** Dijenia mbi formimin profesional
- Figura nr. 4:** Informacioni nga janë informuar mbi AFP-të
- Figura nr. 5:** Preferenca për zgjedhjen mes AFP dhe AMP
- Figura nr. 6:** Tendenca për profilet që synojnë më shumë të rinjtë
- Figura nr. 7:** Mundësia për pagimin e shpenzimeve për shkollim
- Figura nr. 8:** Prirja për të emigruar jashtë dhe format e emigrimit
- Figura nr. 9:** Prirja për të aplikuar për punë jashtë Shqipërisë dhe mënyrat
- Figura nr. 10:** Dëshira për të hapur një biznes dhe çfarë iu nevojitet për këtë
- Figura nr. 11:** Nëse të anketuarit i ishin drejtuar ZVP
- Figura nr. 12:** Aplikimi drejtpërdrejt për punë në një biznes
- Figura nr. 13:** Kualifikimet e nevojshme për të aplikuar për punë
- Figura nr. 14:** Mënyrat e gjetjes së punës në Shqipëri
- Figura nr. 15:** Preferenca për të punuar në sektorin publik apo privat
- Figura nr. 16:** Preferenca dhe mënyra për të emigruar
- Figura nr. 17:** Vendet e preferuara për të emigruar
- Figura nr.18:** Informacioni mbi programet e punësimit në shtetet e tjera
- Figura nr.19:** Burimi i preferuar i informacionit mbi programet e punësimit
- Figura nr.20:** Arsyeja që disa profesione ofertë më të madhe në treg
- Figura nr. 21:** QFP publike dhe private të kontaktuara në secilën bashki
- Figura nr. 22:** Kurset e ofruara dhe preferencat në QFP-të publike dhe private
- Figura nr. 23:** Kohëzgjatja e kurseve
- Figura nr. 24:**Kostot mesatare miniale e maksimale të kurseve
- Figura nr. 25:** Lehtësira për pagesën
- Figura nr. 26:** Ndjekja e kurseve sipas gjinive
- Figura nr. 27:** Mënyrat për shpërndarjen e informacionit nga QFP-të
- Figura nr. 28:** Përmbushja e kushteve të formimit profesional për punësim jashtë vendit
- Figura nr. 29:** Të rinjtë e papunë që drejtohen në zyrat e bashkisë
- Figura nr. 30:** Referimi i rasteve të të rinjve të papunë
- Figura nr. 31:** Këshillimi i të rinjve të papunë për formim profesional ose punësim
- Figura nr. 32:** Grupmoshat që iu drejtohen agjencive private të punësimit dhe bizneseve
- Figura nr. 33:** Informacioni mbi formimin profesional të punëkërkuesve
- Figura nr. 34:** Zotërimi i aftësive të duhura profesionale për të siguruar punë
- Figura nr. 35:** Informacioni mbi Qendrat Private të Formimit Profesional
- Figura nr. 36:** Dobishmëria e Qendrave Private të Formimit Profesional
- Figura nr. 37:**Vlerësimi për profesionet me vende më të lira pune në treg
- Figura nr. 38:** Arsyet e ofertës së lartë të vendeve të lira të punës

I. HYRJE

Ky studim u përgatit në kuadër të projektit “Mbrotjtja e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi”, i menaxhuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe financuar nga Qeveria e Italisë. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është forcimi i masave për mbrotjtjen e fëmijëve nga trafikimi, shfrytëzimi dhe migrimi i pasigurt, nëpërmjet përmirësimit dhe mbështetjes së politikave sociale në lidhje me parandalimin e këtyre fenomeneve dhe mbrotjtjen fëmijëve në rrezik dhe atyre të trafikuar. Qëllimi i projektit përfshin gjithashtu fuqizimin e koordinimit ndërmjet strukturave të mbrotjtjes së fëmijëve dhe ofruesve të formimit profesional për të rritur aksesin e fëmijëve nga shtresat në nevojë në arsimin dhe formimin profesional. Projekti gjithashtu ka orientuar masat koordinuese të punonjësve të mbrotjtjes së fëmijëve me formimin profesional, si dhe ka mbështetur drejtpërsëdrejti me bursa fëmijë nga shtresa në nevojë.

Ky studim u krye nga Qendra Europiane, si zbatuese e komponentit të projektit në lidhje me aksesin e fëmijëve nga shtresat në nevojë në formimin dhe arsimin profesional në pesë bashki kryesore në vend të cilat janë Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Fier. Studimi ka si qëllim të analizojë nevojat dhe mundësitë e fëmijëve të moshës 15-18² vjeç, nga shtresat në nevojë, si dhe nga zonat rurale dhe periferike për të ndjekur arsimin profesional, si një mundësi formimi që kontribuon në largimin e tyre nga fenomene të rrezikshme si trafikimi, shfrytëzimi, migrimi i pasigurt. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi janë paraqitur gjatë takimeve koordinuese midis Punonjësve të Mbrotjtjes së Fëmijëve, Zyra e Rajonale të Punësimit dhe Qendrave të Formimit Profesional. Gjatë zbatimit të projektit, gjetjet e këtij studimi u paraqitën në seanca informuese me të rinjtë, ku ata u njohën me rreziqet e migrimit të parregullt, të drejtat e tyre sipas legjislacionit të punës, rregullave për lëvizjen e lirë dhe përparësitë e formimit profesional.

Për më tepër, gjetjet dhe rekomandimet e studimit janë reflektuar në Planet e Veprimit për Shërbimet Sociale, që po hartohen nga bashkitë nën drejtimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me mbështetjen e disa organizatave ndërkombetare, përfshirë Prezencën e OSBE-së.

Në përfundim, nëpërmjet këtij studimi, është dhënë kontributi në forcimin e sistemit të mbrotjtjes së fëmijëve, duke u koordinuar me zhvillimet e legjislacionit, si Ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional”, “Ligji për të Drejtat dhe Mbrotjtjen e Fëmijës”, si dhe reformat e ndryshme në vend si reforma e decentralizimit dhe ajo e shërbimeve sociale.

² Ligj nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i RSH, ndryshuar, neni 98-Mosha Minimale

II. METODOLOGJIA

Ky studim është cilësor dhe sasior, i cili përmban të dhëna dhe shifra si dhe interpretimin e tyre. Studimi përmban gjithashtu rekomandime bazuar në interpretimin e gjetjeve dhe legjislacionit në fuqi, në fushat e lidhura me studimin, si mbrojtja e fëmijëve, arsimit profesional dhe pushteti vendor.

Për të përmbushur qëllimin e studimit në lidhje me njohjen e nevojave dhe mundësisë së fëmijëve nga shtresat në nevojë për të ndjekur arsimin dhe formimin profesional, janë përdorur pesë lloje pyetësorësh³, të cilët mbledhin të dhëna sasiore në kuadër të këtij studimi nevojash.

Pyetësorët u strukturuan përmes tre protokolle pyetjesh:

1. Pyetje të mbyllura;
2. Pyetje gjysëm të mbyllura;
3. Pyetje të hapura.

Kapionimi: Grupi i targetuar për efekt të këtij studimi përbëhej nga: të rinj të grupmoshës 15-18 vjeç, kryesisht të grupeve në nevojë dhe zonave rurale e periferike. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014-2020, kuadri aktual i arsimit dhe formimit profesionali drejtohet: i) të diplomuarve nga gjimnazet, të cilët nuk regjistrohen në universitete dhe nuk kanë asnjë kualifikim të nevojshëm në tregun e punës, dhe ii) të diplomuarve nga shkollat profesionale, të cilët dëshirojnë të marrin një kualifikim të përparuar profesional⁴. Grupmosha 15-18 vjeç u përzgjedh në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit mosha minimale për të qenë subjekt i këshillimit dhe formimit profesional është 15 vjeç. Intervistat u kryen në bashkitë Tiranë, Shkodër, Fier, Durrës, Elbasan me kërkesë të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, e cila zbaton projektin për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi në këto bashki (n⁵=1000 persona) të anketuar online dhe offline. Gjatë studimit vëmendje e veçantë iu drejtua kuotave gjinore, duke ruajtur një barazi kuotash në të gjithë target grupet e intervistuar. Në total rezultoi se 54% e të intervistuarve ishin femra dhe 46% meshkuj.

Për të patur një tablo gjithëpërfshirëse të nevojave të të rinjve dhe shërbimeve aktuale të formimit profesional, intervista u zhvilluan dhe me Punonjës të Njësitë të Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Drejtorive të Shërbimit Social të Bashkive përkatëse, punonjës të Zyrave Vendore të Punës, Qendrat Publike dhe Private të Formimit Profesional, si edhe Agjencitë Private të Punësimin.

³ Llojet e pyetësorëve: 1. Për grupmoshën 15-18 vjeç; 2. Për Qendrat e Formimit Profesional; 3. Për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve; 4. Për Zyrat Rajonale të Punësimin dhe 5. Agjencitë Private të Punësimin.

⁴ Strategjia Kombëtare Për Punësim Dhe Aftësi, 2014-2020, faqe

⁵ n - është numri total i madhësisë së kampionit që nevojitet të alokohet.




Figura nr. 1: Perspektiva gjinore e të anketuarve

➤ *Të dhënat cilësore*

Përsa i përket komponentit cilësor të studimit u përdorën dy instrumenta: fokus grupet dhe analizmi i kuadrit ligjor, strategjik dhe literaturës në këtë fushë.

Objektivi kryesor i fokus grupeve ishte analizimi i opinionëve të të rinjve dhe familjarëve të tyre, me qëllim identifikimin e rekomandimeve relevante për këtë studim. U zhvilluan pesë fokus grupe, një për secilën bashki. Target grup i tyre ishin persona nga shtresa vulnerabël në rrezik trafikimi. Aksesit në këtë target grup u mundësua nga bashkëpunimi me OJF partnere⁶ dhe aktivistë të të drejtave të njeriut. Në terma të analizës së kuadrit ligjor, strategjik dhe literaturës ekspertët konsultuan legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi, si edhe strategjitë e miratuara nga qeveria. Me qëllim analizimin më në detaj të tyre u bë një vështrim krahasimor me standardet e vendosura nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria dhe praktikatat më të mira të vendeve evropiane.

⁶ Shoqatat partnere në këtë projekt ishin RVA, IRCA dhe aktivistë të komunitetit rom dhe egjiptian në 5 bashkitë e përzgjedhura për projektin.

III. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR MASAT KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE – NË FOKUS MBROJTJA E FËMIJËVE

Në këtë pjesë të studimit do të jepet një kuadër i përgjithshëm ligjor dhe institucional për mbrojtjen dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve⁷. Së pari, do të trajtohen dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, e më tej do të shpjegohet, në mënyrë të përmbledhur, kuadri institucional, duke përmendur disa nga masat e mundshme që duhen marrë për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi në bazë të legjislacionit në fuqi

Të rinjtë zënë pozicionin më vulnerabël në tregun e punës, jo vetëm në Shqipëri, por kudo tjetër në botë. Si derivat i krizës financiare në Bashkimin Europian, shkalla e punësimit të të rinjve është mjaft e ulët dhe normat e papunësisë janë tepër të larta, ku referuar statistikave të papunësisë së të rinjve në mars të vitit 2017, në BE numëroheshin si të papunë 3.388 milion të rinj nën moshën 25 vjeç, e cila krahasuar me marsin e 2016 numri i të papunëve ka pësuar një rënie në masën 439 mijë, por që ende mbetet një shifër e lartë krahasuar me potencialin që kanë të rinjtë për krahun e punës⁸. Në të njëjtën linjë, të rinjtë në Shqipëri zënë normën më të lartë të të papunëve⁹, pavarësisht se ata përbëjnë 25% të popullsisë¹⁰. Në një treg pune i cili ndryshon me hapa tepër të shpejtë, informimi dhe orientimi i të rinjve për t'u përgatitur më mirë me qëllim integrimin në këtë treg është detyrë primare e të gjithë aktorëve, qofshin ata publikë apo privatë. Kjo qasje është përqaftuar në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe është një nevojë e domosdoshme edhe për Shqipërinë.

Për më tepër, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes dhe integritetit të fëmijëve, veçanërisht atyre të cilët mund të jenë viktimat të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit ose dhunës. Sipas legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, këta janë fëmijë që kanë nevojë për masa të posaçme mbrojtjeje¹¹. Për më tepër, duke marrë parasysh se niveli i efekteve të arsimit është në korrelacion pozitiv me rrezikun e këtij grupi të synuar për t'u

⁷ Me fëmijë në bazë të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës së Këshillit të Evropës për Ndërmarjen e Masave Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore kuptohen personat deri në 18 vjeç.

⁸ http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Unemployment_statistics#Youth_unemployment_trends

⁹ <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-pun%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5>, [konsultuar më 30.03.2017] - Shkalla e papunësisë 2007-2016 (tab3) - Sipas Institutit të Statistikave në Shqipëri (INSTAT) mbi studimin e bërë për Shkallën e Papunësisë në Shqipëri për vitin 2016 për grupmoshën e të rinjve 15-29 vjeç është në masën 28.9%, e cila është norma më e lartë krahasuar me grupmoshën 30-64 vjeç në kuotën e 11.8%. Në ndarjen gjinore mbi shkallën e papunësisë vihet re që shkallën më të lartë të papunësisë e përbën gjinia mashkullore me një diferencë 1.9 %.

¹⁰ <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>, Shifrat, Popullsia 1 janar 2001-2017, t_1,

¹¹ Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” - Masa Emergjente e Mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative; Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative, a. pranë një të afërmi; b. pranë një familje kujdestare; në një institucion rezidencial të përkujdesjes.; Mbikqyrje e specializuar e fëmijëve në mjedisin familjar; a. regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe/ose ndjekjen e rregullt të programit mësimor; mbështetje mësimore përmes mësuesve të posaçëm apo klasave të integruara, a. mosfrekuentimin e vendeve të caktuara; b. këshillimi psikologjik; c. trajtimin shëndetsor, nëse është i nevojshëm.

trafikuar, një çështje serioze për t`u shqetësuar është numri i madh i fëmijëve dhe vajzave, që kanë përfunduar vetëm arsimin bazë¹².

Personat vulnerabël ndaj trafikimit janë kryesisht të varur nga një sërë politikash sektoriale dhe ndërsektoriale, duke përfshirë ato në fushën e arsimit, punësimit, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, zhvillimit dhe integritit, barazisë gjinore, mbrojtjes nga dhuna në familje, mbrojtjes së fëmijëve, antidiskriminimit etj. Për këtë arsye, parandalimi i trafikimit përmes marrjes së masave për përmirësimin e politikave dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës publik dhe fuqizimi i arsimit si dhe formimit profesional në përmirësimin e situatës, janë elementë të rëndësishëm të cilët duhen pasur në vëmendje.

Mbrojtja ligjore nga trafikimi dhe shfrytëzimi bazohet në qasjen e të drejtave të njeriut, e cila është një kornizë konceptuale për trajtimin e dukurieve të tilla, të cilat sipas standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut, qëllim final kanë nxitjen dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave¹³.

Të drejtat më të rëndësishme për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit janë¹⁴:

- ✓ E drejta e jetës;
- ✓ E drejta për liri dhe siguri;
- ✓ Ndalimi i skllavërisë, servitudeve dhe punës së detyruar;
- ✓ E drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe/ose trajtimit të pamëshirshëm, çnjerëzor dhe degradues;
- ✓ E drejta për të mos iu nënshtruar dhunës;
- ✓ Ndalimi i diskriminimit për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit fetar, bindjeve politike ose mendimeve të tjera, origjina kombëtare ose sociale, prona, vendlindja ose statuse të tjera;
- ✓ Liria e organizimit;
- ✓ Liria e lëvizjes;
- ✓ E drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor;
- ✓ E drejta për kushte pune të favorshme;
- ✓ E drejta për të pasur një standard jetese të përshtatshëm;
- ✓ E drejta për mbrojtje sociale;
- ✓ E drejta e fëmijëve për të gëzuar mbrojtje të veçantë.

¹²<http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx> Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar sipas cikleve, t_4 për vitin 2014-2015, një numër prej 363408 krahasuar me “Nxënës morën dëftesë liri në arsimin 9-vjeçar, t_2, në masën 44,001 nxënës konsultuar më 08.05.2017

¹³ Shih Office of the High Commissioner for Human Rights, UN, *Human Rights and Human Trafficking: Factsheet No. 36*, gjendet në http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf, konsultuar së fundmi më 30.03.2017

¹⁴ Po aty

Në mbrojtje të të drejtave të viktimave të trafikimit ose viktimave të mundshme të trafikimit, por jo vetëm, vendi ynë ka ratifikuar një sërë marrëveshesh ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm.

Disa prej këtyre marrëveshjeve janë:

- ✓ Konventa e OKB-së Kundër Krimit të Organizuar dhe Protokoli për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve;
- ✓ Konventa e Këshillit të Evropës për Marrjen e Masave Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
- ✓ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ✓ Konventa e OKB-së për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Protokoli i saj Opsional etj.

Ndër këto akte të së drejtës ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore, *Konventa e Këshillit të Evropës “Për marrjen e masave kundër trafikimit të qenieve njerëzore”*¹⁵ parashikon mjaft qartë konceptin e “*trafikimit të qenieve njerëzore*” dhe “*viktimave të trafikimit*”. Më konkretisht Konventa përkufizon se:

*[Trafikimi i qenieve njerëzore nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, të rrëmbimit, të mashtrimit, të abuzimit të pushtetit ose të pozitës së paavantazhuar, ose të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, nivelin minimal të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve, ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punës së detyruar ose shërbimeve, skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, robëri ose heqjen e organeve*¹⁶]. Sipas Konventës *një fëmijë konsiderohet si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore pavarësisht nëse është përdorur ndonjë mjet(detyrimi, mashtrimi, abuzimi me pozicionin e vulnerabilitetit, etj.) për të rekrutuar, transportuar, transferuar, strehuar ose për ta marrë atë për qëllim shfrytëzimi.*

Kjo Konventë është dokumenti i parë ndërkombëtar që përkufizoi termin “*viktimë trafikimi*”, duke mos lejuar më asnjë nga shtetet anëtare të vlerësojë në diskrecion të tij se cilët persona mund të kategorizohen si viktima trafikimi¹⁷. Neni 4 i Konventës përcakton se:

¹⁵ Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimet Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Varshavë, 16 maj 2015 Neni 4 § a.

¹⁶ Po aty

¹⁷ Simoni, S. (2013, Shkurt). Kuadri ligjor mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore “Trajtimi i viktimave të trafikimit si dëshmitarë gjatë procesit gjyqësor. Mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore”. Tiranë: Shkolla e Magjistraturës, f. 75.

[Viktimë do të konsiderohet çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përcaktimeve të këtij neni¹⁸].

Në linjë, vlen të ndalemi edhe në dy dokumente të tjera tepër të rëndësishme, të përmendura më lart, që garantojnë të drejtat dhe marrjen e masave ndaj trafikimit të qenieve njerëzore: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar¹⁹ dhe Protokollin e Palermos²⁰.

Në nenin 9 të *Protokollit të Palermos* parashikohet se shtetet duhet të hartojnë dhe të ndërmarrin politika, programe dhe masa të tjera për parandalimin dhe luftën e trafikimit të qenieve njerëzore, si edhe të mbrojnë viktimat e trafikimit, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve.

Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në nenin 5 të saj parashikon se masat që duhet të ndërmarrin shtetet anëtare për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore janë të tilla si: kërkimi shkencor, informimi dhe ndërgjegjësimi, fushatat arsimore, nismat shoqërore dhe ekonomike, programe trajnimi, si dhe masat që garantojnë mundësi për migracionin e sigurtë dhe krijimin e një mjedisi mbrojtës për fëmijët²¹.

Shpesh herë, anëtarë të një grupi mund të jenë veçanërisht në rrezik trafikimi. Për shëmbull, fëmijët e familjeve që jetojnë kryesisht me lypjen dhe/ose ndihmë ekonomike. Në rrezik trafikimi janë dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët vihen në shënjestër nga trafikantët, për shëmbull, duke u detyruar të lypin, sepse aftësitë e tyre të kufizuara - sidomos nëse janë shumë të dukshme - tërheqin vëmendjen dhe keqardhjen e publikut për t'iu dhurua para. Shpesh, të rinjtë me aftësi të kufizuara konsiderohen si të padëshirueshëm dhe madje mund të jenë subjekt i trafikimit nga vetë familjet e tyre, të cilët, për shkak të aftësisë së kufizuar nuk i çojnë në shkollë dhe i izolojnë duke i bërë më vulnerabël ndaj shfrytëzimit²². Ndërkohë, gratë dhe vajzat kryesisht synohen të trafikohen me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit dhe punës së detyruar në industrinë e shërbimeve, të tilla si kërcimtare nate, kamariere, masazhatore etj²³.

Fëmijët e pakicave kombëtare, të cilët jetojnë në familje të varfra, ata me aftësi të kufizuara, që punojnë dhe që abuzohen dhe/ose trafikohen, nuk kanë akses në kujdesin e hershëm të fëmijërisë²⁴, duke i bërë ata të përballen me një rrezik më të madh për përjashtim shoqëror, arsimor,

¹⁸ Council of Europe Convention On action against trafficking in Human Beings, Ëarshaë, 16 May 2015, Article 4(e).

¹⁹ UN Convention against Transnational Crime.

²⁰ Supplementing Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons Especially Women and Children.

²¹ Kore, Zini. & Lenja, Valbona. (2017). *Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi*. Tiranë: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, f. 9.

²² Trafficking in persons report, June 2016 – Department of State, pg. 24

²³ Shih Office of the High Commissioner for Human Rights, UN, *Human Rights and Human Trafficking: Factsheet No. 36*, at http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf

²⁴ https://www.unicef.org/albania/sq/children_27590.html - *Neuro-shkenca ka konfirmuar se truri i një fëmije, ka nevojë të stimulohet dhe të ndërveproj për të arritur potencialin e plotë. Për këtë, fëmijëve ju duhet ofruar kujdesi dhe trajtimi i duhur mjekësor, ushqimi dhe frekuentimi i qendrave ditore, çerdheve dhe kopshteve, të cilat e përgatisin atë që të jetë i suksesshëm në shkollë, të integrohet në komunitetin e tij, dhe të rritet si një qytetar i përgjegjshëm dhe produktiv.*

shëndetsor, përfaqësimi dhe strehimi²⁵. Fëmijët e grupeve të popullsisë rome dhe egjiptiane dhe fëmijët me aftësi të kufizuara kanë shkallën më të ulët të regjistrimit dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%²⁶.

Në bazë dhe për zbatim të legjislacionit ndërkombëtar të ratifikuar me ligj, si edhe konsolidimit të shtetit të së drejtës, institucionet shqiptare kanë hartuar një sërë politikash, të cilat garantojnë mbrojtje të viktimave të trafikimit dhe grupeve të paavantazuara të cilat janë potencial trafikimi dhe shfrytëzimi. Kështu, mund të përmendim: “Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014-2017”, “Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020”, “Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020” etj.

Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014-2017, përmend ndër të tjera disa objektiva specifike për parandalimin e trafikimit dhe shfrytëzimit të personave me fokus të veçantë grupet vulnerabël. Ndër të tjera, kjo strategji liston si objektiva:

1. Rritja e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e personave dhe pasojat e tij tek grupet e identikuara “*në rrezik*”;
2. Rritja e rolit të medias në parandalimin e trafikimit;
3. Përmirësimi i përfshirjes sociale të grupeve që përbëjnë viktimat të mundshme trafikimi²⁷.

Disa prej synimeve të kësaj strategjie janë parandalimi i trafikimit të personave, duke ulur vulnerabilitetin, rritur mbrojtjen, dhënien e ndihmës për ri-integrim për personat e trafikuar. Sigurisht, sukcesi i këtyre politikave varet gjerësisht nga një sërë sektorësh dhe politikash ndërsektoriale, përfshirë ato në fushat e punësimin, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, arsimit etj²⁸.

Trafikimi i fëmijëve është një problem shqetësues në botë dhe në Shqipëri. Fëmijët trafikohen për një larmi qëllimesh, përfshirë ato për shfrytëzimin seksual, lypje të detyruar, si dhe forma të tjera të punës së detyruar, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Lypja e detyruar në rrugë e fëmijëve mbetet një problem i madh, po ashtu edhe lypja dhe puna e detyruar (sezonale) në qendrat turistike në Shqipëri. Që prej vitit 2014, trajtimi i fenomenit të fëmijëve në situatë rruge ka marrë përparësi institucionale. Me synim mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” në 2014. Veprimet për identifikimin dhe asistencën e fëmijëve në situatë rruge bazohen në Planin Kombëtar të Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015 - 2017”, i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e

²⁵Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. *Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020*, f. 20.

²⁶Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, f. 11

²⁷Kore, Zini. & Lenja, Valbona. (2017). *Cituar më lart*, f. 9.

²⁸Ministria e Brendshme. *Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014-2017*, f. 17.

abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, nëpërmjet një ndërhyrje të plotë, të integruar ndër-sektoriale për mbrojtjen e fëmijëve dhe forcimin e familjeve të tyre ²⁹.

Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020, paraqet një sërë fushash të rëndësishme, në të cilat duhet të ndërmerren masa për përfshirjen sociale, me fokus të veçantë personat që vuajnë nga përjashtimi social dhe diskriminimi. Ndër të tjera, këto fusha përfshijnë: aksesin në punësim dhe tregun e punës, aksesin në arsim gjithëpërfshirës për çdo fëmijë, mundësi strehimi për të gjithë personat që janë në situatë vulnerabël dhe përfitimi i shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse³⁰.

Rëndësia strategjike e arsimit për të luftuar varfërinë, përjashtimin social dhe trafikimin theksohet në *Strategjinë e Bashkimit Europian 2020*, ku arsimi përkufizohet si forcë shtytëse për të luftuar pabarazinë dhe varfërinë³¹.

Në këtë kuadër, duke e vlerësuar arsimin dhe formimin profesional si një aset të rëndësishëm në përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, sikurse e përmendëm më parë, ky studim ka identifikuar se cilat janë nevojat për formim profesional dhe punësim të grupeve vulnerabël, aksesin e tyre në AFP, duke e krahasuar këtë me nevojat e sektorit të biznesit në bashkitë të cilat janë specifikuar dhe në metodologjinë e këtij projekti.

Kështu, në pjesën në vazhdim do të analizohen të dhënat e disagreguara nga studimi i nevojave në terren në pesë bashkitë e sipërpërmendura dhe në përfundim të tyre do të paraqiten rekomandime për politikëbërësit, pushtetin vendor dhe kontribuesit e tjerë në fushën e arsimit dhe formimit profesional mbi rritjen e aksesit të grupeve vulnerabël në këtë lloj arsimit dhe formimi.

²⁹ Plani Kombëtar i Veprimit "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017"; Raport vjetor korrik 2015 - qershor 2016.

³⁰Kore, Zini. & Lenja, Valbona. (2017). *Cituar më lart*, f. 10.

³¹Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. *Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020*, f. 75.

IV. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL I ARSMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL NË SHQIPËRI

Përmirësimi dhe fuqizimi i arsimit profesional është një ndër hapat thelbësore dhe mjaft të rëndësishme që një shtet duhet të ketë në vëmendje, në mënyrë që t'u përgjigjet më së miri nevojave dhe kërkesave të tregut të punës. Orientimi i të rinjve drejt arsimit profesional është një gur themeli për uljen e papunësisë si dhe dekurajimin e migrimit të parregullt. Vëmendje të veçantë në këtë raport do t'i kushtohet masave të ndërmarra në përmirësimin e arsimit dhe formimit profesional e për rrjedhojë nxitjes së të rinjve drejt këtij profili, si një aset i vlefshëm për hyrjen më lehtë në tregun e punës.

Në vijim të këtij materiali, do të paraqesim një panoramë të mbrojtjes së të drejtës së edukimit të parashikuar nga instrumentet legjislativë ndërkombëtare, ku ndër to përmendim: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike etj., e më pas do të vijohet me parashikimet e instrumenteve kombëtare.

*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*³² në nenin 26 të saj parashikon se kushdo ka të drejtë të arsimohet, dhe arsimit i tij/saj duhet të jetë falas, të paktën në fazat e arsimit fillor dhe themelor. Po ashtu një parashikim në këtë nen është bërë dhe për arsimin profesional ku shprehimisht thuhet se: *[Arsimi teknik dhe profesional duhet të jetë i përgjithshëm, ndërsa arsimit i lartë duhet t'u mundësohet të gjithëve në mënyrë të barabartë në bazë të aftësisë].*

Edukimi është përfshirë në DUDNJ si një nga të drejtat themelore të njeriut. Qëllimi dhe përmbajtja e edukimit jepet në paragrafin e dytë të nenit 26 të Deklaratës. Komisioni i DUDNJ-së e pa të nevojshme dhënien e disa udhëzime për përmbajtjen dhe qëllimin e sistemit arsimor³³, të tilla si arsimit falas, mundësia e përgjithshme e sigurimit të arsimit profesional dhe teknik, qasje e barabartë në arsimin e lartë dhe e drejta e prindërve për të zgjedhur llojin e arsimit që do t'u jepet fëmijëve të tyre. Pra, neni 26 i Deklaratës evidenton karakteristikat e arsimit demokratik.

Deklarata për të Drejtat e Fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1959.³⁴ Deklarata lidh të mirën e fëmijës me të mirën e shoqërisë dhe thekson që “*njerëzimi i detyrohet fëmijës më të mirën që mund të ofrojë*”. Nëpërmjet kësaj deklarate fëmijës i njihej e drejta për arsim falas dhe të detyrueshëm të paktën në shkollat fillore. Qëllimi i arsimit, për të promovuar kulturën e përgjithshme të fëmijës dhe për ta mundësuar atë që mbi bazë të shanseve të barabarta të zhvillojë gjykimin e tij individual, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë morale dhe sociale, për t'u bërë një anëtar i dobishëm i shoqërisë, kërkonte që shteti

³²DUDNJ – 10 dhjetor 1948

³³Halvorsen, K. “Notes on the realization of the Human Right to Education”, Human Rights Quarterly, Vol. 12, No. 3. (Aug., 1990), f. 353

³⁴ Për më shumë shiko: <https://www.unicef.org/malaysia/1959-Declaration-of-the-Rights-of-the-Child.pdf>

të përgjigjej me struktura arsimore publike të ngritura dhe të shpërndara, për ta bërë të mundur realizimin e kësaj të drejte.

*Pakti Ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” 1966*³⁵, në dallim nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e cila përbënte një dokument jo të detyrueshëm nga pikëpamja ligjore në aspektin ndërkombëtar, vendoste detyrime ligjore për shtetet anëtare, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në të drejtën për arsim në nenet 13³⁶ dhe 14 të tij. Arsimi i mesëm nuk kërkohet të jetë i detyrueshëm. Arsimi i mesëm duhet të jetë në dispozicion në mënyrë të përgjithshme dhe i hapur për të gjithë, me të gjitha mjetet e përshtatshme, sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimit falas. Shprehja “*me të gjitha mjetet e përshtatshme*” i mëshon akoma më shumë faktit që shtetet duhet të miratojnë metoda të ndryshme dhe inovative për të bërë të mundur shpërndarjen e arsimit të mesëm në kushte të ndryshme sociale dhe kulturore.

Sipas *Konvetës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në neni 2 të Protokollit 1 të saj*, askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Kjo përfshin të drejtën për arsimim efektiv (që është i përshtatshëm); për të hyrë në institucionet arsimore ekzistuese; për t'u arsimuar në gjuhën kombëtare; dhe për njohjen zyrtare në përfundim të studimeve të tij. Kjo e drejtë përfshin arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Kjo e drejtë i takon nxënësve, të cilëve nuk duhet t'u mohohet e drejta për arsimim. Pra, neni 2 i Protokollit Nr. 1 lidhet me edukimin fillestar³⁷, por edhe arsimin e mesëm³⁸ dhe kurset e specializuara. Për rrjedhojë neni 2 i Protokollit Nr. 1 garanton të drejtën për arsim për fëmijët, të rriturit, dhe çdo person që dëshiron të përfitojë nga e drejta për arsimim³⁹. Gjithashtu “E drejta e arsimit”, shprehet në nenin 28 të Konventës Evropiane “Për të Drejtat e Fëmijës”, që citon se “*Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim*”.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European parashikon në nenin 14 të saj të drejtën për arsimim.⁴⁰ Duke qenë se Shqipëria është një vend që aspirojnë futjen në Bashkimin Evropian, është mjaft i rëndësishëm fakti që zbatimi i të drejtave themelore dhe përafrimi i legjislacionit të shkojë në një linjë me standardet europiane. Gjithashtu sipas raportit të KE për Shqipërinë më 9 nëntor 2016 në kapitullin e 26 të tij Komisioni ka ngritur disa problematika në të cilat Shqipëria duhet të bëjë përpjekje për të zhvilluar koordinimin me punëdhënësit, zhvillimin e vazhdueshëm të

³⁵ [Aderimi i Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është miratuar me ligjin. Nr. 7511, datë 08.08.1991. Shqipëria ka aderuar më 04 Tetor 1991. Për më shumë shiko: http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryIDç2&LangçEN]

³⁶ Neni 13 § 2 (b) Arsimi i mesëm, në format e tij të ndryshme, duke përfshirë arsimin e mesëm teknik dhe profesional, duhet të jetë në dispozicion në mënyrë të përgjithshme dhe i hapur për të gjithë me të gjitha mjetet e përshtatshme sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimit falas;

³⁷ Sulak k. Turqisë

³⁸ Qipro k. Turqisë [DHM], § 278

³⁹ Velyo Velev k. Bullgarisë

⁴⁰ 1. Kushdo ka të drejtë të arsimohet dhe të ketë akses tek trajnimi apo formimi profesional dhe i vazhdueshëm. 2. Kjo e drejtë përfshin mundësinë për të kryer falas arsimin e detyrueshëm. karta e të drejtave themelore e bashkimit evropian 3. Liria për të themeluar institucione arsimore që respektojnë parimet demokratike si dhe e drejta e prindërve për t'u garantuar fëmijëve të tyre arsimimin dhe mësimdhënien në përputhje me besimin e tyre fetar, filozofik dhe pedagogjik, respektohet në përputhje me ligjet kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj lirie dhe të drejte.

kurrikulës dhe skemat e integruara të të mësuarit me bazë punën, ku ndër të tjera Shqipëria ka miratuar dhe ligjin mbi arsimin profesional dhe trajnimin (APT), të rrisë lidhjet midis aftësive dhe kërkesës për punë, të zhvillojë bazat e të dhënave dhe të burimeve në internet në dispozicion për ofruesit e APT.

Në raportin e fundit të *Komisionit European* në lidhje me *politikat sociale dhe punësimin*⁴¹ është vërejtur se ka pasur pak progres, sidomos me miratimin e ndryshimeve në Kodin e Punës dhe Ligjit për Ndihmën Ekonomike, Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe Dokumentin dhe Planine Veprimit 2016-2020 për politikat profesionale, të sigurisë dhe ato shëndetësore. Zbatimi i strategjisë kombëtare të vendeve të punës dhe aftësive ka filluar, por shkalla e punësimit dhe pjesëmarrja në tregun e punës mbeten të ulta, dhe ekonomia informale është ende një punëdhënëse e rëndësishme. Pjesa e punësimit të cenueshëm në vitin 2012 ishte 61.4 %, në të cilin punëtorët e rinj në moshë dhe femrat e të gjitha moshave janë më të rrezikuar se grupet e tjera të punëtorëve (përkatësisht, 72.8 % dhe 67.7 %).⁴² Sipas raportit, ende vazhdon zbatimi i strategjisë kombëtare 2014-2020 për vendet e punës dhe aftësitë, dhe për monitorimin e saj ka një mekanizëm.⁴³ Për sa i përket përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, janë miratuar Strategjia e re Kombëtare për Mbrojtje Sociale 2015-2020 dhe një Dokument i Politikave për Përfshirjen Sociale. Të dy dokumentet e politikave përcaktojnë objektivat për uljen e varfërisë, monitorimin e politikave të përfshirjes ndër-sektoriale, miratimin e reformave në fushën e mos-diskriminimit dhe krijimin e një sistemi të kujdesit social. Punësimi i të miturve mbetet një shqetësim i madh, duke përfshirë edhe punën e tyre në mjedise të rrezikshme, për rrjedhojë kërkohet ndërmarrja e më shumë masave efektive, për të parandaluar punën e të miturve.

Në lidhje me *arsimin dhe kulturën*⁴⁴ BE mbështet bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe kulturës përmes programeve të financimit që vetë BE ofron p.sh. përmes Erasmus+⁴⁵ apo Ambasada Amerikane⁴⁶ dhe përmes metodës së hapur të koordinimit. Shtetet anëtare duhet të parandalojnë diskriminimin dhe lehtësojnë arsimimin e fëmijëve të punëtorëve emigrantë të BE-së. Në këtë raport theksohet përmirësimi i nevojshëm i cilësisë së arsimit, pasi kërkesat për t'u larguar jashtë, apo emigracioni i të rinjve të kualifikuar është i lartë ndërsa mundësitë për punë janë më të ulëta.⁴⁷ Ashtu si tregojnë rezultatet e PISA, Shqipëria është shumë më poshtë se mesatarja e OECD dhe BE-së në drejtim të aftësive bazë të moshës 15 vjeçare.⁴⁸ Ka nevojë për më shumë bashkëpunim mes institucioneve arsimore dhe sektorit të biznesit për të përgatitur më mirë të diplomuarit për zhvillim të tregut të punës.

⁴¹ Kapitulli 19, Raporti i KE për Shqipërinë, 9 nëntor 2016

⁴² Startegjia Kombëtare për Punësim dhe aftësi 2014-2020, f. 50.

⁴³ Ministrinë e Linjës janë përgjegjëse për zbatimin e strategjive dhe për rrjedhojë monitorimi është vetë përgjegjësi e ministrive të linjës, në rastin konkret i Ministrisë së Mirqenies Sociale dhe Rinisë.

⁴⁴ Kapitulli 26, Raporti i KE për Shqipërinë, 9 nëntor 2016, f. 93

⁴⁵ http://erasmusplus.al/?page_id=2891

⁴⁶ <https://al.usembassy.gov/sq/education-culture-sq/educational-exchange-programs-sq/>

⁴⁷ Kapitulli 26, Raporti i KE për Shqipërinë, 9 nëntor 2016

⁴⁸ <http://gpseducation.oecd.org/CountryProfile?primaryCountry=ALB&treshold=10&topic=PI>

Në një linjë me instrumentet ndërkombëtare qëndrojnë dhe instrumentat kombëtare duke nisur nga Kushtetuta e Republikës⁴⁹, Kodi i Punës⁵⁰, ligji i sapo miratuar për Arsimin dhe Formimin Profesional⁵¹. “Startegjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020”, “Plani i veprimtimit 2014-2017”, të cilat përmbajnë objektiva specifike në lidhje me ndreqjen e mangësive në arsim dhe kualifikim, trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes së varfërisë dhe mosinteretit të lartë të të rinjve për punë, si edhe lidhjen midis kërkesës dhe ofertës së tregut të punës.

Kushtetuta në nenin 57 § 4⁵² të saj citon se arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie”.

*Kodi i Punës i ndryshuar hyri në fuqi në qershor të vitit 2016. Ligji i ri synon të transpozojë direktivat e ndryshme të BE-së që mbulojnë mos-diskriminimin në vendin e punës, të drejtat prindërore, të drejtën e informimit, marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës dhe punën në distancë (teleworking). Ky ligj gjithashtu rrit moshën minimale të punës nga **14 në 15 vjeç**, në përputhje me konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Megjithatë, dispozitat për punën e detyruar mbeten të paqarta dhe ligji nuk parashikon sanksione në rastet e shkeljes. Në qershor, ligji për zanatet u miratua nga parlamenti⁵³.*

*Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional i ka dhënë një shtysë më të madhe forcimit të arsimit profesional dhe lidhjes së tij me tregun e punës. Ky ligj mbështetet në **tre pika** kryesore për zgjidhjen e ngërçit të mungesave që tregu i punës ka lidhur me profesionistët dhe zanatçinjtë, duke i kthyer shkollat e arsimit profesional **në**:*

- *Njësi autonome financiare;*
- *Vendosjen e urave lidhëse me biznesin;* dhe njëherësh
- *Ndërthurjen e dijeve teorike dhe praktike* gjatë gjithë viteve të formimit pranë këtyre shkollave.

Sipas ligjit për arsimin dhe formimin profesional, **Arsimi dhe Formimi Profesional** është një fushë e aftësive profesionale, që kombinon arsimin me praktikën profesionale, e cila pajis individët me njohuri dhe shprehje të veçanta si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t’u punësuar në një profesion të caktuar dhe për t’u integruar në tregun e punës.⁵⁴ Sistemi i arsimit profesional është i

⁴⁹Ligji nr. 8417, dt. 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar.

⁵⁰Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë, ndryshuar.

⁵¹Ligji 15/2017, Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë

⁵² 1. Kushdo ka të drejtën për arsimim. 2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj. 3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë. 4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie. 5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. 6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit. 7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.

⁵³ Raporti i KE, 9 nëntor 2016

⁵⁴ Ligji 15/2017 për Arsimin dhe Formimin Profesional në RSH, neni 4/3

ndarë në dy ofrues kryesorë që janë Shkollat e Mesme Profesionale (SHMP) dhe Qendrat e Formimit Profesional (QFP).

SHMP - Që nga viti 2009/10, arsimit fillestar profesional është dhënë në tre nivele për t'iu ofruar studentëve si arsimin e përgjithshëm, ashtu edhe atë profesional (teorik dhe praktik), duke i përgatitur për punë dhe arsimim të mëtejshëm. Programet dy-vjeçare në nivelin e parë synojnë formimin e punëtorëve gjysmë të aftësuar. Studentët e suksesshëm marrin një certifikatë bazë të formimit profesional dhe mund të hyjnë në tregun e punës ose të vazhdojnë studimet e tyre në nivelin pasardhës. Në nivelin e dytë, programet njëvjeçare përgatisin teknikë dhe i çojnë ata drejt marrjes së një certifikate të formimit profesional. Përfundimi i programeve tekniko-profesionale në nivelin e tretë, që zgjat edhe një vit më shumë, u hap rrugën për arsimin e lartë. Në fund të këtij niveli studentët japin provimin e Maturës shtetërore dhe provimin e praktikës profesionale.⁵⁵ Në fushën e Arsimit dhe Formimit profesional ekzistojnë, 29 drejtime të cilat janë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.⁵⁶

QFP - janë institucione publike dhe jo-publike në të cilat ofrohen kualifikime aftshkurtër në nivel kombëtar ose qendror, nga 4 muaj- 6 muaj në profesione të kërkuara nga tregu i punës. Nëse kurset profesionale të Nivelit Kombëtar janë unike për të gjitha Qendrat e Formimit Profesional në vend, Kurset profesionale në Nivel Qendre, janë kurse specifike që ofrohen nga qendrat profesionale në funksion të kërkesave që kanë bizneset lokale etj. Kurset në nivel Kombëtar ofrohen sipas Programeve të hartuara nga AKAFPK dhe të miratuara nga Ministri, ndërsa kurset në Nivel Qendre, zhvillohen sipas Programeve të hartuara nga specialistët e qëndrës, në bashkëpunim me ato të biznesit përkatës. Për sa i përket kohë shtrirjes, zakonisht Kurset Kombëtare janë kualifikime profesionale afat gjatë (por jo më shumë se dy vite), ndërsa ato në Nivel Qendre janë afat shkurtër dhe shërbejnë kryesisht për kualifikime të shkurtëra, për procese të ndryshme teknologjike etj. Në përfundim të kurseve të Kombëtare, kursantët pajisen me Çertifikatë të unifikuar në të gjithë vendin, ndërsa për kurset në nivel Qendre certifikata përgatitet nga vetë Qendra.⁵⁷

Ligji i ri kërkon që shkollat e Arsimit dhe Formimit Profesional të mos jenë thjesht shkolla të edukimit standard⁵⁸, por një vend ku nxënësit marrin njohuri dhe i vendosin ato në praktikë në laboratorët respektive të shkollave ku ata janë duke u formuar. Gjithashtu sipas këtij ligji synohet transformimi i tyre në *qendra shumëfunksionale*⁵⁹, të cilat në çdo kurrikul të përgatitin studentë të

⁵⁵ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, f. 23

⁵⁶ Administrim Biznesi, Agrobiznes, Bujqësi, Elektronikë, Gjeodezi, Hoteleri turizëm, Instalues i sistemeve termohidraulike, Llogari, Mbështetje e përdoruesve të TIK, Mekanikë, Ndërtim, Përpunim Druri, Rrjete të dhënash, Shërbime bankare, Shërbime mjetesh transporti, Shërbime sociale dhe shëndetsore, Silvikulturë, Sipërmarrje e agjencisë turistike, Teknologji kimike, teknologji ushqimore, Tekstil konfeksione, Veterinari, Harri Fulltz automekanik, Harri Fulltz biznes, Harri Fulltz elektronikë, Zhvillim website; Sigurime dhe Peter Mahringer

⁵⁷ Për më shumë shiko http://www.vet.al/qendrat_formimit_profesional

⁵⁸ Kuptimi i termit “edukim” jepet në nenin 1 të Rekomandimit të UNESCO “Për Edukimin për Mirëkuptim Ndërkombëtar, Bashkëpunim dhe Paqe dhe Edukimin lidhur me Të drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut” (1974). Sipas këtij neni “*edukim do të thotë i gjithë procesi i jetës sociale nëpërmjet të cilit individët dhe grupet shoqërore mësojnë të zhvillojnë me vetëdije për të mirën e komuniteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të gjithë kapacitetin e tyre personal, qëndrimet, prirjeve dhe njohuritë. Ky proces nuk është i kufizuar në ndonjë veprimtari të veçantë.*”

⁵⁹ Neni 4 § 19 i ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”

kualifikuar për kërkesat e tregut të punës. Qendrat shumëfunktionale do të jenë hapësira jo vetëm për nxënësit e shkollës së mesme, por dhe për të rriturit ku biznesi të ketë mundësinë të ofrojë kurse dhe trajnime në bazë të specifikave të punës. Ligji vjen po kaq i lidhur dhe me kodin e punës, pas miratimit të ligjit punëkërkuësve të papunë dhe miratimit e implementimit të ligjit të zejeve.

Investimet e buxhetit të shtetit për vitin 2016-2017 janë të orientuara në tre aspekte si më poshtë vijon:

- 1) **Zgjerimi i kapaciteteve të shkollave.** Shkollat e Arsimit dhe Formimit Profesional për vitin akademik 2015-2016 shënuan numër të lartë të nxënësve dhe studentëve që zgjedhin arsimin profesional në një shifër prej 25 mijë e 428 nxënës⁶⁰. Shkollat e Arsimit Profesional në qendrat e mëdha janë të mbipopulluara. Shkollat në Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, janë po ashtu të mbipopulluara. Për rrjedhojë ka nevojë për investim në shtimin e klasave, laboratorëve dhe shkollave të reja.⁶¹;
- 2) Në kuadër të ligjit të ri, qendrat e formimit profesional **janë shndërruar në qendra shumëfunktionale**⁶², duke kërkuar më shumë hapësira për më shumë laboratore dhe baza prodhuese. E për rrjedhojë, në investimet e vitit 2016 është kërkuar transformimi rrënjësor i shkollave në Shkodër, Durrës, Tiranë, Fier.⁶³ Gjithashtu duhet theksuar se laboratorët tejet modern që kanë shkolla e mesme profesionale e Kamzës, “Arben Broci” në Shkodër, shkolla e mesme profesionale “Petro Sota” Fier, u ofrojnë mundësi nxënësve për marrjen e diplomave europiane përmes binjakëzimeve të ndryshme që janë bërë me shkollat më të mira europiane të Arsimit dhe Formimit Profesional, po ashtu dhe përmes zhvillimit të praktikës në vend në biznese të huaja me të cilat mund të kenë vendosur marrëveshje bashkëpunimi;
- 3) Në kuadër të ligjit të ri të arsimit dhe formimit profesional janë duke u bërë më shumë përpjekje për **cilësinë në mësimdhënie**. Ligji i ri parashikon diçka të re lidhur me menaxhimin e të ardhurave nga vetë shkollat. Po kaq e domosdoshme dhe e rëndësishme është dhe **trajnimi instruktorëve të arsimit** dhe formimit profesional, ku përmes të ardhurave që shkollat do të mbledhin nga administrimi dhe ofrimi i kurseve, dhe produkteve që dalin nga vetë puna e nxënësve në praktikën mësimore, paratë e fituara të mund të administrohen nga shkollat për krijuar një staf mësuesish dhe instruktorësh të kualifikuar.

Një fokus i rëndësishëm, drejt të cilit duhet të mësohet shumë fort është **marrëdhënia dhe bashkëpunimi i pandashëm që duhet të ketë arsimit profesional me biznesin**. Në ligjin e sapo miratuar, por dhe në të kaluarin i është dhënë një vëmendje e veçantë marrëdhënies së shkollës me

⁶⁰<http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx>, Nxënës të regjistruar në shkollat e mesme, t. 5.

⁶¹ Studim Bazë i Ofruesve Publik të AFP-së në Shqipëri, Raport Final (GIZ dhe ETF, 2014), f. 63

⁶² Neni 4 § 19 e ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”

⁶³ Financimi i AFP-së bëhet nga buxheti i shtetit sipas procedurave ligjore në fuqi dhe udhëzimit të përbashkët të MMSR dhe Ministrisë së Financave; gjithashtu nga të ardhurat e gjeneruara nga vetë ofruesit publik të AFP-së, kontributet e donatorëve, sponsorizimet.

bordin e drejtuesve⁶⁴ të saj, ku e rëndësishme dhe thelbësore është krijimi i marrëdhënies së rëndësishme dhe po kaq funksionale mes profilit të shkollës dhe biznesit respektiv.

Në këtë mënyrë shkolla do të menaxhohet nga Bordi Drejtues⁶⁵ i lidhur me biznesin, përfaqësues të njërive arsimore vendore, përfaqësues të këshillit të qarkut, përfaqësues të zyrës rajonale/vendore të punësimit, përfaqësues të personelit të mësimdhënies të institucionit publik, përfaqësues i nxënësve për shkollat publike të arsimit profesional ose një përfaqësues të punëmarrësve për QFP

Shkollat e formimit profesional janë *me sistemin të dyfishtë*⁶⁶, ku kombinohet shkollimi me punën dhe aftësimin praktik në ndërmarrje. Sipas të dhënave të INSTAT, nxënësit që zgjedhin arsimin profesional në Shqipëri, krahasuar me ata që zgjedhin arsimin e mesëm janë në raportin 19.5% arsimi profesional kundrejt 80.5% për arsimin e mesëm të përgjithshëm, gjë që kërkon rritje të kapaciteteve, rritje të cilësisë të shkollës të arsimit profesional⁶⁷.

Bazuar në ligjin e ri “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, në nenin 26 të tij garantohet mbrojtja nga çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Në nenin 34 dhe 49 të ligjit të ri parashikohen mekanizmat institucionale për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Një ndër këto mekanizma në nivel vendor janë dhe NJMF-të ku, sipas ligjit të ri, çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka me tepër se 3000 fëmijë duhet të ketë minimalisht një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve.⁶⁸ Më tej, punonjësit e NJMF-ve kanë për detyrë të marrin masa mbrojtëse ndaj fëmijëve që janë në rrezik abuzimi, shfrytëzimi, apo neglizhimi, duke përfshirë dhe marrjen e masave të menjëhershme, nëse fëmijët janë në rrezik të lartë. Një parashikim tepër i rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijës ka të bëjë me detyrimin për raportim nga mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social në shkollë; Punonjësit e institucioneve shëndetësore, apo të përkujdesjes së fëmijës, institucionet publike ose private kanë për detyrë të raportojnë menjëherë për çdo rast të dyshuar, apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit apo dhunës të fëmijët në organet e Policisë së Shtetit apo Strukturat për Mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.⁶⁹

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020”, vë në dukje problematikat dhe përmirësimet që duhet t’i bëhen sistemit arsimor profesional dhe më tepër qasjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Në këtë kuadër, objektivat e saj në këto dy komponentë mjaft të rëndësishëm konsistojnë në riorganizimin e kurrikulave për t’iu qasur më tepër nevojave të tregut të punës, përmirësimin e kushteve pranë shkollave apo qendrave të formimit profesional me laboratorë dhe

⁶⁴Neni 13 - Bordi Drejtues i ofruesve publikë të AFP-së, Ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në RSH”

⁶⁵Po aty, Neni 13

⁶⁶Neni 4/7 dhe 22 i ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”

⁶⁷Nxënës të regjistruar në shkollat e mesme t_5, Sipas statistikave të vitit akademik 2015-2016 rezulton se nga 130,380 nxënës që janë të regjistruar në total në shkollat e mesme, 104,952 ndjekin shkollën e mesme të përgjithshme dhe 25,428 ndjekin shkollë të mesme profesionale.

⁶⁸Ligj nr. 18/2017 datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 50

⁶⁹Ligj nr. 18/2017 datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 67

teknologji moderne dhe të kohës, lidhjen mes tyre dhe biznesit si dhe kualifikimin e instruktorëve dhe mësuesve pranë institucioneve të arsimit profesional. Dy sistemet e ndara të ofruesve të AFP-së në shkolla profesionale dhe qendra publike të kualifikimit profesional duhet të shkrihen në një duke krijuar një qendër multifunkionale ku nxënësit shumë mirë mund të arsimohen dhe njëherësh të kryejnë praktikë në po të njëjtin vend. Ky ndryshim është parashikuar dhe në ligjin e ri për Arsimin dhe Formimin Profesional, duke e orientuar arsimin profesional drejt kërkesave të tregut të punës, kombinimin e teorisë me praktikën dhe bashkëpunimin e ngushtë me biznesin.

V. GJETJET KRYESORE TË STUDIMIT


5.1 Sfidat dhe vështirësitë për të përfituar nga arsimi dhe formimi profesional

Qëllimi i pyetësorit për 15-18 vjeçarët ishte mbledhja e informacionit në lidhje me arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që përmes anketimit të kuptonim më qartë nevojat e të rinjve dhe në këtë formë të mund të kontribuojmë përmes gjetjeve dhe rekomandimeve në përmirësimin e aksesit së të rinjve kryesisht të grupeve në nevojë në sistemin aktual të formimit profesional në Shqipëri, duke mundësuar rritjen e aftësive të tyre profesionale dhe zbutjen e vulnerabilitetit ndaj trafikimit, shfrytëzimit dhe migrimit të rrezikshëm.

80 % e pyetësorëve u plotësuan në 25 takime të zhvilluara në 25 shkolla të ciklit 9-vjeçare në pesë bashkitë e përzgjedhura për këtë projekt. Takimet në shkolla u mundësuan nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale në katër pesë bashki.⁷⁰

Në secilën bashki në bashkëpunim me DAR-et përkatëse u evidentuan dhe vizituan 5 shkolla periferike 9-vjeçare, u intervistuan fëmijë të cilët vinin nga nivele të ndryshme ekonomike, por kryesisht nga ata që i përkasin familjeve më të ardhura tepër të ulta, ata që jetonin me asistencë ekonomike, fëmijë që jetojnë vetëm me një nga prindërit, fëmijë që i përkasin popullsisë romë dhe egjiptiane si dhe u zhvilluan pesë fokus grupe me pjesëmarrës të këtyre moshave për të parë prirjet dhe qasjet që kishin ata drejt arsimit dhe formimit profesional. Grafikët në fokus grupe u evidentuan në bashkëpunim me organizata të tjera jofitimprurëse, të cilat punojnë me shtresa në nevojë dhe me aktivistë të të drejtave të njeriut.

Në një ndarje sipas qyteteve: 24% e fëmijëve u intervistuan në Bashkinë Tiranë, 20% në Bashkinë Fier, 20% në Bashkinë Durrës, 19% në Bashkinë Elbasan dhe 18% në Bashkinë Shkodër. Ndër këta të intervistuar 20% e tyre ishin pjesë e komunitetit rom dhe egjiptian (n=170). Ndërkohë nga fokus grupet u arritën të nxirren të dhëna cilësore.



⁷⁰ Shkollat dhe fshatrat ku janë kryer anketimet i gjeni në shtojcat në fund të këtij studimi.

Figura nr. 2: Përqindja e të anketuarve në secilën Bashki

Së pari, fëmijët u pyetën në lidhje me faktin nëse janë të informuar dhe kanë dijeni për arsimin dhe formimin profesional. Më tepër se gjysma e tyre u shprehën negativisht, konkretisht 55%, në raport me 45% të cilët zgjodhën përgjigjen pozitive të pasjes dijeni mbi arsimin dhe formimit profesional.




Figura nr. 3: Dijenia mbi formimin profesional

Ashtu siç specifikohet dhe në tabelën 4, në masën 49% është zgjedhur opsioni “*Interneti*”, i cili siç dihet është një nga mjetet më të fuqishme dhe më të shpejta për shpërndarjen e informacionit dhe i përdorur në masë nga të rinjtë. Në anën tjetër, 31% e të anketuarve në 5 bashkitë e përzgjedhura të marra së bashku, pasi trendi ishte thuajse i njëjtë për secilën bashki, u përgjigjën se kishin marrë dijeni mbi AFP-të nga shkollat profesionale në fushata dhe sesione informimi të zhvilluara prej tyre ose organizatave të ndryshme, që duan të nxisin arsimin profesional te të rinjtë. Ndërkohë që 11% e të rinjve kishin zgjedhur opsionin “*Pa përgjigje*”.




Figura nr. 4: Informacioni nga janë informuar mbi AFP-të

Pyetja e radhës, në këtë formular, konsistonte në dëshirën që kishin fëmijët e intervistuar për të ndjekur një shkollë të mesme profesionale apo qendër të formimit profesional. Dhe në rast të

zgjedhjes së opsionit pozitiv, përse kishin bërë këtë zgjedhje. Më konkretisht përqindjet e preferencave për këtë pyetje pasqyrohen në tabelën nr. 5.

Sipas të dhënave të dizagreguara të anketimit, prirja lidhej më tepër në dëshirën e tyre për zgjedhjen e arsimit të mesëm të përgjithshëm në masën 49% krahasuar me 31% të tyre, të cilët shprehën dëshirën për të ndjekur AFP. Duhet theksuar se një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nuk kishin një përgjigje për këtë pyetje, konkretisht 20% e tyre. Ata që kanë zgjedhur përgjigjen pozitive, u shprehën se i tërhiqte ideja për të marrë një formim profesional, pasi i përgatit më herët në jetë dhe për më tepër marrin një zanat dhe do të kenë mundësi për të gjetur më lehtë punë dhe për të fituar të ardhura. Po ashtu, një pjesë e tyre janë shprehur se do të marrin zanatin e prindërve apo të afërmëve të tyre dhe një pjesë tjetër se duan të vazhdojnë biznesin që ka familja e tyre. Ndërkohë që ata që kanë zgjedhur përgjigjen negative kryesisht kanë preferuar të vazhdojnë arsimin e përgjithshëm dhe më tej akoma të kenë mundësinë për të ndjekur universitetin. Në këtë linjë ka disa të anketuar që janë shprehur se pas shkollës së lartë mund të kërkonin të kualifikoheshin në një nga kurset e arsimit dhe formimit profesional për të përmirësuar aspektin e tyre praktik.




Figura nr. 5: Preferenca për zgjedhjen mes AFP dhe AMP

Në vazhdim me pyetjen e radhës, të anketuarit të cilët u përgjigjën se do të pëlqenin të ndiqnin AFP u pyetën mbi drejtimin që do të preferonin të zgjidhnin. Pasi u listuan një sërë profilesh⁷¹ u vërejt se pjesa më e madhe e tyre, konkretisht 28%, pavarësisht se do të pëlqenin të ndiqnin AFP, nuk kishin një ide të qartë se cili profil i përshtatej më tepër.

Vihet re një preferencë e barabartë në përqindje në masën 9% mes profesionit të kuzhinier dhe T.I.K. Profesionit i kuzhinierit pëlqehet dhe është zgjedhur thajse njëlloj nga të dyja gjinitë. Në

⁷¹ Referuar në profilet e AFP-ve publike, por edhe atyre private, megjithëse nuk ka një listim të të gjithë kurseve private të formimit profesional.

lidhje me informatikën, të rinjtë tërhiqen më shumë drejt inovacioneve teknologjike. Shkolla ekonomike preferohet të ndiqet nga 8% e të rinjve dhe kryesisht perspektiva ka qëndruar në ndjekjen e fakultetit më tej. Profesionet e elektricitetit dhe hidraulikut pëlqehen në masën 7% për t'u ndjekur nga gjuhët e huaja 5%, rrobaqepësia 4%, parukeri dhe hoteleri-turizëm në 3% dhe në fund me 2% profesione të tilla si veterinari, sekretari dhe elektro-teknike.

Nga rezultatet e intervistave derivoi se përgjigja "Tjetër" mbante masën prej 14%, ku të rinjtë kishin dhënë disa alternativa mbi këtë të tilla si marangoz, shpues naftë, punues duralumini, murator etj.




Figura nr. 6: Tendencat për profilet që synojnë më shumë të rinjtë

Lidhur me mundësinë e pagimit të shpenzimeve, përgjigjet e të cilave gjenden të pasqyruara në tabelën 6, për mundësinë e mbulimit ekonomik mbi arsimin dhe formimin profesional tendencat konsistojnë në pagimin e shpenzimeve për shkollim nga familja në masën prej 69%. Ndërkohë, që ajo pasohet nga ata persona që janë përgjigjur se mund të siguronin një bursë për t'u arsimuar në një nga shkollat e mesme/qendrat e formimit profesional, por nuk kanë shprehur ndonjë përgjigje sesi do t'i përfitonin këto bursa. Një numër i ulët i të anketuarve, konkretisht 8%, u shprehën se mund të gjenin një formë tjetër financimi, duke punuar dhe studiuar paralelisht. Ndërsa, 9% e tyre nuk kishin një ide të qartë si mund të financonin shkollimin.




Figura nr. 7: Mundësia për pagimin e shpenzimeve për shkollim

Anketimi u ndal edhe në vlerësimin nëse të intervistuarit kishin tentuar të emigronin dhe nëse po në çfarë mënyre. Nga përgjigjet e marra nga të anketuarit, të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 7, 76% e të intervistuarve u shprehën se nuk kishin tentuar të emigronin ndonjëherë, krahasuar me 15%, që deklarorin se kishin tentuar të emigronin në mënyrë të rregullt. Ndërkohë që një përqindje prej 7% kishin plotësuar opsionin se kishin tentuar të emigronin në mënyrë të parregullt së bashku me familjet e tyre dhe kjo kryesisht për shkak të kushteve të vështira ekonomike.




Figura nr. 8: Prirja për të emigruar jashtë dhe format e emigrimit

Për të vijuar në të njëjtën linjë me pyetjen e mësipërme anketimi ka pasur në fokus dhe prirjen që kanë të rinjtë, apo familjet e tyre për të aplikuar për punë jashtë Shqipërisë dhe mënyrat sesi ka ndodhur.

Nga të dhënat e procesuara rezultoi se 91% e tyre janë përgjigjur se nuk kanë tentuar të aplikojnë për punë jashtë Shqipërisë, krahasuar me 6% të tyre që kanë provuar të aplikojnë për një punë jashtë vendit.

Pjesa e të anketuarve që janë përgjigjur negativisht janë shprehur se nuk kanë mbushur moshën për t'u larguar jashtë shtetit, ose ata që janë në një moshë më të rritur janë shprehur se fillimisht

duhet të arsimohen në një profil të caktuar, qoftë dhe një kurs profesional në mënyrë për të shkuar dhe ushtruar një zana në vendin që mund të aplikojnë për t'u larguar në të ardhmen. Ndërkohë ata që kanë zgjedhur përgjigjen "Po", shprehen se kanë tentuar të aplikojnë përmes të afërmëve që kanë jashtë vendit, apo përmes agjencive të huaja të punësimit. Tabela nr. 9 pasqyron përqindjet e shpjeguara më sipër.




Figura nr. 9: Prirja për të aplikuar për punë jashtë Shqipërisë dhe mënyrat

Lidhur me faktin nëse të rinjtë do të dëshironin të hapnin një biznes të vogël në qytetin/fshatin ku ata jetojnë, prirja ka qenë më e madhe në përgjigjen: "Po", në masën prej 65%. Ndërkohë që 31% kanë zgjedhur opsionin "Jo". Një numër i konsiderueshëm i atyre që kanë zgjedhur opsionin pozitiv janë shprehur se iu duhen para për të hapur një biznes, mbështetje për të cilën pjesa më e madhe synonte ta gjente nga familja, e cila duket se për mentalitetin shqiptar mbetet dhe shihet ende si një mbështetje kryesore, pavarësisht kushteve tepër të vështira ekonomike që kanë disa prej tyre. Gjithashtu disa prej të anketuarve janë shprehur se iu nevojitet arsimimi i duhur, e shumë prej tyre janë shprehur se do iu duhej një partner për të hapur një biznes. Biznesi për të cilin pjesa më e madhe e të rinjve meshkuj do të dëshironin të hapnin ishte një sallë kompjuterash, ose një kafene. Ndërkohë që nga ana tjetër vajzat preferonin një biznes që lidhej me rrobaqepësi-stilim, parukerinë apo veterinarinë.




Figura nr. 10: Dëshira për të hapur një biznes dhe çfarë iu nevojitet për këtë.

Në vazhdim, të anketuarit u pyetën nëse i ishin drejtuar ndonjëherë zyrës së punës vendore në qytetin e tyre. 89 % e të intervistuarve u shprehën se nuk i ishin drejtuar ndonjëherë zyrës së punës dhe vetëm 11 % u përgjigjën pozitivisht. Arsyeja pse një numër kaq i madh nuk i janë drejtuar ndonjëherë zyrës së punës lidhet me moshën e tyre. Një pjesë tjetër e të rinjve janë shprehur se preferojnë më tepër të kërkojnë në internet, apo gazeta për të gjetur punën që ata do të dëshironin dhe me pagesën që do iu pëlqente. Ndërkohë që ata që kanë zgjedhur opsionin pozitiv ishin shprehur se ndjeheshin më të sigurt lidhur me zbatimin rigoroz të kontratës së punës në rast se ata do të referoheshin nga Zyra e Punës drejt një biznesi apo kompanie.




Figura nr. 11: Nëse të anketuarit i ishin drejtuar ZVP

Subjektet e anketuara u pyetën edhe nëse kishin aplikuar drejtpërdrejt për punë në një biznes, ku 62% prej tyre u përgjigjën negativisht. Ndërkohë, që 38% e tyre rezultoi se kishin aplikuar për punë pranë një biznesi në mënyrë të drejtpërdrejtë.




Figura nr. 12: Aplikimi drejtpërdrejt për punë në një biznes

Të anketuarit të cilët i ishin drejtuar biznesit për t`u punësuar u përgjigjën se në masën 67% nuk përmbushnin kualifikimet profesionale të kërkuara. Ndërkohë, që vetëm 33% prej tyre përmbushnin këto aftësi dhe kualifikime të kërkuara për punën specifike për të cilën kishin aplikuar




Figura nr. 13: Kualifikimet e nevojshme për të aplikuar për punë

Grupi i intervistuar u pyet në lidhje me informacionin që zotëronin për mënyrat e gjetjes së punës në Shqipëri. Pjesa më e madhe e tyre, respektivisht 30%, vlerësonin se zyrat e punës janë aktori kryesor në gjetjen e punës në Shqipëri. Ndërkohë, 26% e tyre u përgjigjën se në vendin tonë mund të përfitosh punë përmes referimit nga të njohurit. Pothuajse në të njëjtin nivel qëndron dhe mundësia e punësimit përmes njoftimeve të publikuara në internet. Media e shkruar shihet nga fëmijët dhe të rinjtë si një opsion jo shumë efektiv në gjetjen e punës, konkretisht 15% e tyre dhanë këtë vlerësim. 2% e të intervistuarve, nuk kishin një përgjigje në lidhje me mënyrat e gjetjes së ofertave të punësimit në vendin tonë.




Figura nr. 14: Mënyrat e gjetjes së punës në Shqipëri

Përsa i përket preferencës së sektorit ku dëshirojnë të punësohen, 54% e target grupit të anketuar preferonte sektorin privat, duke qenë se aty gjenin më shumë mundësi për të promovuar aftësitë e tyre dhe për të marrë më shumë të ardhura, kundrejt 46% prej tyre që preferonte sektorin publik për të qenë më të sigurt dhe për të qenë më komodë.




Figura nr. 15: Preferenca për të punuar në sektorin publik apo privat

Gjithashtu, fëmijët dhe të rinjtë u pyetën nëse do të preferonin të emigronin jashtë vendit dhe cilën mënyrë vlerësonin si më të efektive. 45% e tyre u shprehën se do të preferonin të emigronin, duke u ndihmuar nga të njohurit e tyre, ndërsa 20% e atyre që do të preferonin të emigronin mendonin të përfitonin nga programet e punësimit. Nga target grupi i intervistuar 23% e tyre nuk do të preferonin të emigronin. Ndërkohë, që 12% nuk kishin një përgjigje në lidhje me këtë çështje.




Figura nr. 16: Preferenca dhe mënyra për të emigruar

Në lidhje me vendet të cilat do të preferonin të emigronin fëmijët ata u përgjigjën në masën 43% se do të preferonin Republikën Federale Gjermane për të emigruar, ndjekur nga Italia me 32% dhe Mbretëria e Bashkuar me 11%. Ndërkohë, 14% e të intervistuarve përzgjedhën vende të tjera të Bashkimit Europian dhe Shtetet e Bashkuara.




Figura nr. 17: Vendet e preferuara për të emigruar

Gjithashtu, fëmijët u pyetën nëse ishin në dijeni të programeve të punësimit në shtetet e tjera. Pjesa më e madhe e tyre, konkretisht 80% kishin dijeni mbi këto programe përmes mënyrave të ndryshme të pasqyruara në tabelën nr. 18. Ndërkohë, që vetëm 20% e të intervistuarve nuk kishin njohuri mbi programet e punësimit në shtetet e tjera.




Figura nr.18: Informacioni mbi programet e punësimit në shtetet e tjera

Më tej, personat të cilët nuk kishin informacion mbi programet e punësimit u pyetën në lidhje me mënyrën se ku do ta kërkonin informacionin mbi programet e punësimit, në rast nevojë. Burimi kryesor drejt të cilit të rinjtë u përgjigjën se do të përdornin për të kërkuar informacion rezultoi të ishte interneti, në masën 69%, krahasuar me 29% të të anketuarve të cilët do t`iu drejtoheshin faqeve zyrtare të ambasadave.




Figura nr. 19: Burimi i preferuar i informacionit mbi programet e punësimit

Lidhur me profesionin, që fëmijët do të preferonin të kryenin në një vend jashtë Shqipërisë, përgjigjet më të shumta lidhen me degët e teknologjisë, si informatika, inxhinieria informatike, telekomunikacioni, qoftë si programues apo nga ata që punojnë në servise kompjuterash. Ky profesion ndiqet nga elektrikist, hidraulik apo mekanik. Kjo prirje vihet re më tepër te gjinia mashkullore. Nga ana tjetër gjinia femërore ka prirje më të mëdha për të ndjekur një profesion që lidhet me mjekësinë, infermierinë, ekonomikun dhe rrobaqepsinë. Profesionin si kuzhinier, apo përkthyes përgjithësisht ka pëlqim të njëjtë si nga gjinia mashkullore ashtu dhe nga gjinia femërore.

5.2 Masat e marra nga Zyrtat Vendore të Punësimit në lidhje me formimin profesional të punkërkuesve

Lidhur me anketimin drejtuar pesë zyrave të punës në pesë bashkitë në të cilat u krye ky studim, qëllimi në vetvete konsistonte në informacionin që ZVP kanë lidhur me formimin profesional të punëkërkuesve dhe kontribimin në përmirësimin e sistemit aktual të formimit profesional në Shqipëri. Në secilën prej pesë bashkive të përzgjedhura u vendos kontakti me përgjegjësit e këtyre zyrave dhe u zhvilluan takime për marrjen e të dhënave përmes pyetësorit të posaçëm.

Lidhur me pyetjen drejtuar ZVP mbi të dhëna/raporte apo analiza nga ana e SHKP-së për preferencat e bizneseve për rekrutimin e punonjësve të rinj, ZVP-të e pesë bashkive u përgjigjën pozitivisht. Ato u shprehën se ekzistojnë raporte mbi programet e nxitjes së punësimit në Shqipëri, në të cilat parashtrihen masat e nevojshme dhe sfidat për punësim parë këto në këndvështrimin e punëkërkuesve dhe punonjësve të SHKP-së⁷². Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësi 2014-2020 parashtron situatën aktuale të tregut të punës dhe nxitjen e punësimit të denjë përmes politikave të frytshme të tregut të punës, duke ofruar arsim dhe formim profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, duke nxitur përhshirjen shoqërore dhe njëherësh kohezionin territorial. Gjithashtu në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit i është dedikuar një hapsirë e posaçme programeve të nxitjes së punësimit dhe publikimit të VKM-ve për programet e nxitjes së punësimit veçanërisht të personat që kanë qenë dhe targeti kryesor i studimit tonë siç janë të rinjtë, viktimat e trafikimit, persona nga komuniteti rom apo egjiptian dhe persona me aftësi të kufizuara etj⁷³.

Nga ana tjetër, secila prej zyrave vendore të punësimit është përgjigjur se janë vetë bizneset ata që kontaktojnë me specialistët e Shërbimit Kombëtar të Punësimit me qëllim punësimin e të rinjve. Ato konstatojnë se një pjesë e mirë e kërkesave të paraqitura pranë zyrave të punës janë për profesione të tilla si: picajol, tekstil, teknik në industrinë e naftës, marketing etj. Për çdo vend pune që hapet në subjektet e biznesit ata sjellin ofertën e tyre pranë ZVP, por lidhur me të dhëna statistikore mbi rekrutimin e punonjësve të rinj ZVP-të nuk dhanë përgjigje.

Ndërkohë Zyra vendore e punësimit Durrës konstaton se ekziston një analizë e quajtur “Skills Needs Analysis” që është një anketim, i cili realizohet periodikisht një herë në dy vjet, ku në një nga kapitujt e tij të rëndësishëm është dhe trajtimi i rekrutimit si një nga elementet më të rëndësishëm ku shqyrtohen me kujdes mënyrat e rekrutimit, profesionet e kërkuara, aftësitë e kërkuara, vështirësitë në rekrutim si dhe mënyrat sesi bizneset mendojnë t’i zgjidhin problematikat që hasin. Anketa e fundit është realizuar në vitin 2014-2015⁷⁴ dhe pritet që brenda 6 mujorit të parë të vitit 2017 të kryhet anketimi i radhës.

Në lidhje me pyetjen e target grupit nëse ka pasur raste të paraqitjes në zyrat e punësimit të grupmoshave 15-18 vjeç për të kërkuar punë, secila prej zyrave vendore të punësimit është përgjigjur pozitivisht, por pa dhënë informacion mbi numrin e kërkesave të kësaj grupmoshe. Sipas ZVP-ve përgjithësisht personat e kësaj grupmoshe nuk kanë kualifikime të mjaftueshme për të punuar dhe pjesa më e madhe e atyre që drejtohen vijnë nga kurse profesionale afatshkurtra apo nxënës të sapo dalë nga bankat e shkollës, të cilët përgjithësisht janë pa përvojën apo kualifikimet e duhura. Duke qenë se kërkesat më të mëdha të këtyre të rinjve vijnë kryesisht për elektrikistë, saldatorë, parukeri apo kuzhinierë, zyrat shërbejnë si një urë lidhëse për drejtimin e tyre më të mirë në një vend pune në profilin përkatës.

⁷² <http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/EPPAlbania-Final-Report-Alb-Final.pdf>

⁷³ <http://www.kerkojpune.gov.al/sherbimet/programet-e-tregut-te-punes/>

⁷⁴ http://www.kerkojpune.gov.al/ep-content/uploads/2015/02/SKILL-NEEDS-ANALYSES-2014-survey_Final-Report.pdf

Lidhur me kategoritë e punëve që ofrohen në treg dhe të cilat janë më të përshtatshme për grupmoshën objekt studimi, ZVP-të u shprehën se profesionet me numrin më të madh të vendeve të lira të punës në treg janë: elektrikist, hidraulik, rrobaqepës dhe kuzhinier. Nuk përjashtohen punonjësit e shërbimit sidomos, kamarier, banakier, operator në *call center* dhe shitëse. Zyra vendore e punësimit Durrës është ndalur më tepër në këtë pyetje duke shpjeguar si më poshtë vijon: *“Në zyrat e punësimit bizneset shpallin shpesh vendet e tyre të lira të punës, por jo të gjithë veprojnë në këtë mënyrë dhe për rrjedhojë mund të flasim vetëm për vendet e lira që shpallen në zyrat e punësimit. Përbërja e ofertave të punës sipas veprimtarive ekonomike për vitin 2016 ka qenë:*

- *Spektori i Industrisë Përpunuese me 16,234 ose 42% e totalit;*
- *Spektori i Informacionit dhe Komunikacionit 6,453 ose 16% e totalit;*
- *Spektori i Shërbimeve të tjera 3,198 ose 8.3% e totalit.*
- *Ndërtimi 2,207 ose 5.7% e totalit;*
- *Akomodimi dhe shërbimi ushqimor 1,741 ose 4.5% e totalit.*
- *Tregtia 2,135 ose 3.9% e totalit.*

Nga totali i ofertave të punës 30.64% janë për zejtarë dhe 23% për specialistë me arsim të lartë, nëpunës dhe teknikë të mesëm.

Lidhur me profesionet që kanë më tepër vende të lira pune në treg, vihet re një kërkesë e ndarë në mënyrë thujse të njëjtë mbi profile të tilla si elektrikist, hidraulik, rrobaqepësi, punëtorë krahu, kamarier, banakier apo call center. Një shpërndarje të tillë ka dhe kërkesa për informatikë, por kjo kërkesë vjen më tepër nga persona që kanë mbaruar arsimin e lartë. Në bashki të ndryshme u vu re se ka një ofertë punësimi më të lartë për kategori të caktuara punësh si, punëtor në industri, kryesisht në industrinë përpunuese apo atë të peshkimit në bashkinë e Durrësit, rrobaqepësinë dhe sidomos qepësit e lëkurës apo tekstileve në bashkinë e Elbasanit, shpim dhe shfrytëzim nafte dhe gazi, si dhe po kaq për specialistë për makineri të rënda, pompim dhe inxhinier për shpime direksionale në bashkinë e Fierit. Ofertat më të larta në këto profesione në qytete të ndryshme hasen për shkak të pozicionit gjeografik ose karakteristikave të industrisë/biznesit të secilit qytet.

Ashtu si mund të vihet re dhe në figurën nr.20 arsyeja pse disa profesione⁷⁵ kanë më shumë vende të lira pune në treg konsiston në interesin e ulët që ka për këto profesione. Një nga arsyet e interesit të ulët qëndron në:

- pagat e ulëta që ofron tregu i punës.
- kushtet jo tërheqëse të punës (26 % e të anketuarve)
- mungesa e prespektives për karrierë (10 % e të anketuarëve)

⁷⁵ Profesionet për të cilat raportohen më shumë vende të lira pune në treg janë: rrobaqepësi, punonjës në call center, hidraulik, elektrikist, punëtor krahu, specialist për makineri të rënda, qepës lëkure apo tekstilësh, kamarier.

Në përfundim, në pjesën e komenteve në pyetësor vetë ZVP-të janë shprehur se i takon shtetit të rrisë masat kontrolluese ndaj bizneseve që ofrojnë këto vende pune, duke i subvencionuar për rritjen e pagave apo përmirësimin e kushteve të punës dhe duke sanksionuar ato biznese që nuk plotësojnë kushtet në vendin e punës apo caktojnë paga dyshme për profesione, të cilat janë të një vështirësie veçantë.




Figura nr.20: Arsyet që disa profesione ofertë më të madhe në treg

5.3 Ofertat e Arsimit Publik Profesional dhe Arsimit Privat Profesional në 5 bashkitë e përzgjedhura

Sikurse u përmend më lart, qendrat e arsimit profesional janë publike dhe private. Për secilën nga pesë bashkitë e përfshira në projekt u vendosën kontakte dhe u zhvilluan takime për marrjen e të dhënave përmes pyetësorit të posaçëm të përgatitur për qendrat e arsimit profesional. Në secilën bashki ka nga një qendër publike të formimit profesional me përjashtim të Tiranës e cila përbëhet nga dy qendra të formimit profesional⁷⁶. Figurat në vijim tregojnë përqindjen e qendrave publike dhe private të kontaktuara fillimisht për secilën bashki dhe më pas në raport me njëra-tjetrën:

⁷⁶ DRFPP Tirana. 1; DRFPP Tirana 4; DRFPP Durrës; DRFPP Fier; DRFPP Shkodër; DRFPP Elbasan.




Figura nr. 21: QFP publike dhe private të kontaktuara në secilën bashki

Qendrat e formimit profesional, ofrojnë një gamë të gjerë kursesh formimi, ku nënë *Shtojcën II* të këtij studimi gjeni kurset që ofrojnë QFP-të publike. Megjithatë, kurset më tepër të ofruara si në qendrat publike, ashtu edhe private të formimit profesional janë sekretaria, e preferuar kryesisht nga femrat, në masën 80% të pyetësorëve të plotësuar, e ndjekur nga kurset për profesionin e saldatorit dhe elektro-auto, në masën 70% të pyetësorëve të plotësuar, kurse që frekuentohen nga meshkuj⁷⁷.

⁷⁷ Për informacion më të detajuar mund të konsultoni <http://www.vet.al/>




Figura nr. 22: Kurset e ofruara dhe preferencat në QFP-të publike dhe private

Në lidhje me kohëzgjatjen për kurset e ofruara si në qendrat e formimit publik, ashtu edhe ato private, në figurat në vijim shihet një mbizotërim i kurseve të ofruara për një periudhë 6-mujore. 70% e pyetësorëve tregojnë se për kurse të profileve të ndryshme kohëzgjatja më e shpeshtë është ajo 6-mujore, e ndjekur nga kurse 1 dhe 2 mujore me 50% të përgjigjeve në pyetësorë. Gjithashtu, hasen edhe kurse që ofrohen për kohëzgjatje të ndërmjetme si 1 muaj e gjysëm apo 2 muaj e gjysëm. Rastet e paraqitura në grafik si kurse 9, 12 dhe 24-mujore lidhen me lloje kursesh që ofrohen në nivele të ndryshme; fillestare, të mesme dhe të përparuara. Kjo e dhënë përforcohet nga përgjigjet e marra për pyetjen tjetër të pyetësorit nëse kurset e ofruara janë për nivele të ndryshme njohurish apo jo, pyetje që rezulton kryesisht me përgjigje pozitive.




Figura nr. 23: Kohëzgjatja e kurseve

Një nga pyetjet për qendrat e formimit profesional lidhet me kostot për nivel kursi. Ajo që bie në sy nga pyetësorët është dallimi midis kostove të kurseve në qendrat e formimit profesional publik nga ato private. Në të parat kostot janë më të ulta. Gjithashtu, në qendrat e formimit profesional publik ofrohen edhe kurse pa pagesë për personat e regjistruar si të papunë në zyrat e punës, përkundrejt paraqitjes së dokumentacionit vërtetues të këtij fakti. Nëse u referohemi të dhënave të pyetësorëve për kostot minimale dhe maksimale të kurseve të ofruara, në qendra publike dhe private vërejmë se për një nivel kursi kosto minimale është 2.000 lekë, kurse maksimalja 30.000 lekë⁷⁸. Figura në vijim paraqet përgjigjet e marra përmes pyetësorëve për koston mesatare minimale dhe maksimale të të gjitha kurseve të ofruara në qendrat e formimit profesional publik e privat. Kurset që kushtojnë më shumë janë ato në të cilat nevojiten mjete pune që konsumohen, si për shembull në kurset për kuzhinier apo ato të parukeri-estetikës.

⁷⁸ Shifrat i referohen nivelit të kursit. Nëse kurset ofrohen në më shumë se një nivel, niveli vijues i kursit ka pagesë tjetër.




Figura nr. 24: Kostot mesatare miniale e maksimale të kurseve

Në lidhje me lehtësitë për kursantët në formën e zbritjes së tarifës për kurs apo pagesat pjesore të tarifës së kursit, vërejmë se përgjigjet janë të ekuilibruara, me prirje drejt përgjigjes favorizuese ndaj lehtësirave në pagesën e kurseve.




Figura nr. 25: Lehtësira për pagesën

Gjithashtu, përmes pyetësorëve gjeneruam informacion lidhur me gjininë që ka kërkesa për formim profesional. Të dhënat e grumbullura në të gjitha qendrat e formimit profesional publike dhe private tregojnë se gjysmat e përgjigjeve të pyetësorëve shkojnë për alternativën se të dyja gjinitë shfaqin të njëjtin interesim për kurse profesionale. Raporti gjinor meshkuj - femra në

frekuentimin e kurseve të formimit profesional varet kryesisht nga lloji i kurseve, megjithatë alternativa “i ndjekin njësoj” është mbizotëruese në përgjigjet e pyetësorit në masën 50%. Pra, në gjysmat e pyetësorëve, instruktorët nuk bëjnë dallimin se cila nga gjinitë i frekuenton më shumë kurset që ata ofrojnë.

Në lidhje me instruktorët informacioni i përgjithshëm i marrë nga takimet me drejtues të qendrave të formimit profesional është që ata janë të punësuar me kontrata në varësi të kurseve.




Figura nr. 26: Ndjekja e kurseve sipas gjinive

Nga të dhënat e pyetësorëve rezulton se qendrat e formimit profesional, si publike, ashtu edhe private përdorin paralelisht mënyra të ndryshme për të ofruar sa më shumë informacion mbi ekzistencën e tyre dhe mundësitë që ofrojnë ndaj të rinjve. Shpërndarja e informacionit me anë të teknologjive bashkëkohore është në përqindjen më të lartë, 80%. Qendrat e formimit profesional publike dhe private përdorin faqet e tyre të internetit, portale të tjera në internet, si dhe rrjetet sociale për të tërhequr të rinjtë të marrin një formim profesional sipas prirjeve apo interesave. Mënyra të tjera pothuajse po kaq të përdorura rezultojnë reklamat (edhe në media lokale), fletëpalosjet informuese mbi qendrat dhe kurset përkatëse. Në 50% të përgjigjeve rezulton se përmes rretheve shoqërore, familjare apo kursantëve të diplomuar shpërndahet informacion tek të rinjtë. Qendrat e formimit profesional publike dhe private vetëm në 20% të rasteve kanë zgjedhur zyrat e punës në bashkitë përkatëse si përçuese të informacionit mbi mundësitë e formimit profesional.




Figura nr. 27: Mënyrat për shpërndarjen e informacionit nga QFP-të

Në **DRFPP Tirana nr. 4** morëm informacion se numri i nxënësve për vitin akademik 2016 ishte në rreth 4300 të regjistruar, 3000 të certifikuar dhe 2000 punëkërkues pa punë. 494 prej të certifikuarve rezultojnë të punësuar, por ky numër mund të jetë edhe më i lartë. Numri i personave me arsim të lartë, të cilët preferojnë të marrin më tepër njohje praktike lidhur me shkollën që kanë përfunduar, zgjedhin një kurs të formimit profesional krahasuar me ata me arsim 9-vjeçar që vijnë pranë kësaj drejtorie është thujse i barabartë. Gjithashtu, raportohet se drejtoria nr. 4 Tiranë ofron kurse edhe në burgje ku mund të llogaritet një shifër prej 300 të trajnuarish.

Në **DRFPP Tirana nr.1** morëm informacion se gjatë vitit 2016 kanë marrë arsim profesional rreth 4200 nxënës, kurse nga arsimi i lartë ka patur kursantë në masën 20 %. Edhe kjo drejtori ka ofruar trajnime tek burgu i grave. Në të dyja drejtoritëraporti gjinor për preferencën e kurseve është 55% meshkuj dhe 45% femra. Pranë Bashkisë Tiranë ka nisur të funksionojë dhe Drejtoria e Nxitjes së Punësimit, si një masë aktive për të nxitur dhe mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës me qëllim uljen e papunësisë.

Një qendër private, “IRISOFT” raporton për rreth 1000 nxënës në vit dhe duke qenë se është dhe agjenci punësimi private, në të njëjtën kohë ka ofruar punësim për rreth 20 persona gjatë një viti.




Figura nr. 28: Përbushja e kushteve të formimit profesional për punësim jashtë vendit

Pyetja e fundit në pyetësin për qendrat e formimit profesional ishte në lidhje me marrëveshjet e punësimit që Shqipëria ka me shtete të tjera dhe nëse të rinjtë shqiptarë i përbushin kushtet e formimit profesional për profesionet e kërkuara në këto vende. Sipas anketimit të kryer pranë QFP-ve, 80% e tyre u shprehën se mundësitë për t'u punësuar në një vend tjetër janë tepër të larta nëse individit që aplikon ka marrë një formim profesional. Shqipëria ka marrëveshje me vende të tilla si Katari apo Italia për punësimin e të rinjve jashtë vendit. Por ka dhe vende si Gjermania, e cila kërkon më tepër persona që kanë marrë një formim në një shkollë të mesme profesionale sesa në një qendër të formimit profesional, por një kusht tjetër i domosdoshëm për këtë shtet për të gjithë ata persona që aplikojnë për tu punësuar është dhe pasja e njohurive mesatare të gjuhës gjermane.

5.4 Masat e marra nga institucionet vendore për formimin profesional të grupeve vulnerabël ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit - Drejtoritë e Shërbimit Social pranë Bashkive

Një nga pyetësit e përgatitur lidhet me marrjen e informacionit për formimin profesional të të rinjve, përfshirë edhe informacion mbi grupet vulnerabël ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit prej Drejtorive të Shërbimit Social pranë bashkive të përzgjedhura për zbatimin e projektit.

- ***Të rinjtë që u drejtohen Drejtorive të Shërbimit Social pranë Bashkive***

Fillimisht u vendosën kontakte me drejtoritë përkatëse të shërbimit social në bashkitë Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Shkodër. Të pesta drejtoritë e kontaktuara shfaqën gatishmëri për ndarje informacioni dhe dhënie shpjegimesh në kuadër të projektit të konkretizuara me takime ndërmjet stafit të projektit dhe drejtuesit dhe punonjësit e këtyre drejtorive. Të dhënat e mbledhura në lidhje

me numrin e rasteve që kontaktojnë çdo vit drejtoritë e shërbimit social në bashkitë e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Fierit dhe Shkodrës paraqiten në figurën e mëposhtme. Duhet të sqarojmë se në Tiranë dhe Durrës pyetësorët janë plotësuar nga disa zyra, pasi përveç Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkitë Tiranë dhe Durrës pyetësorët janë shpërndarë dhe plotësuar në zyrat e shërbimit social në të gjitha njësitë administrative të këtyre dy bashkive.

Në 95% të zyrave të intervistuar, raportohet se çdo vit pranë tyre drejtohen për këshillim dhe informacion deri në 500 të rinj. Ka edhe 3 raste nga njësitë administrative në Tiranë (me ndarjen e mëparshme administrativo-territoriale ishin komuna) ku nuk raportohet asnjë rast komunikimi me zyrën përkatëse gjatë vitit 2016. Vetëm Drejtoria e Shërbimit Social pranë Bashkisë Tiranë, që është njëkohësisht edhe Bashkia më e madhe në vend, raporton për një shifër më të lartë se 1000 të rinj në vit që drejtohen pranë saj brenda një viti.




Figura nr. 29: Të rinjtë e papunë që drejtohen në zyrat e bashkisë

- ***Orientimi që iu ofrohet të rinjve të papunë***

Në lidhje me aspektin këshillimor e ndihmues që u ofrohet të rinjve të papunë të dhënat e grumbulluara nga pyetësi përkatës shfaqin katër prirje përgjigjesh: zyrat e punës, qendrat e formimit profesional, projekte për rritje kapacitetesh të të rinjve, ku zakonisht më shumë sesa një alternativë është zgjedhur nga secila zyrë apo drejtori e shërbimit social nisur nga problematikat familjare, gjendja shoqërore apo arsimore që shfaqin të rinjtë. Sikundër paraqitet edhe në grafik referimet janë kryesisht për te zyrat e punës në masën 80% të të gjitha përgjigjeve në 5 bashkitë e përfshira në pyetësor. Ndërsa gati 66.7% e përgjigjeve, dëshmojnë për orientime drejt qendrave të formimit profesional. Pjesa tjetër e alternativa të zgjedhura, përkatësisht 26,7% dhe 13,3% janë përkatësisht raste të referimit tek projekte që ndihmojnë për rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe

biznese të ndryshme vendore. Pra, prirjet janë tepër të ngjashme në të gjitha bashkitë ku është fokusuar projekti.




Figura nr. 30: Referimi i rasteve të të rinjve të papunë

- *Këshillimi i të rinjve të papunë për gjetjen e një kursi të formimit profesional apo pune*

Në lidhje me mundësitë që u ofrohen të rinjve të papunë përmes këshillimit dhe orientimi për t'i dhënë zgjidhje çështjes së trajnimit të tyre sipas prirjeve dhe sidomos zgjidhjes së çështjes së papunësisë, prirjet që vihen re në bashkitë e përfshira në projekt paraqiten grafikisht më poshtë:




Figura nr. 31: Këshillimi i të rinjve të papunë për formim profesional ose punësim

Në të gjitha bashkitë e intervistuar rezultoi se alternativa e përbashkët mbizotëruese është këshillimi nga zyrat e shërbimit të kujdesit social dhe komunitar që gjenden pranë bashkive në masën e 64,7% të përgjigjeve, e ndjekur nga këshillimi prej punonjësve të zyrave të punës në masën 58,8%. Mundësi të tjera, më pak të hasura, janë këshillime nga punonjës socialë, të cilët punojnë me projekte për fuqizimin e të rinjve, apo edhe OJF që gjithashtu me veprimtaritë e tyre synojnë të ndihmojnë në integrimin e të rinjve në shoqëri.

- ***Një vështrim mbi rastet e trajtuara nga Agjencitë Private të Punësimit***

Sikurse e përmendëm në hyrjen e këtij studimi, një ndër target grupet e intervistuar për qëllim të këtij studimi janë dhe agjencitë private të punësimit dhe biznesi. Në secilën bashki të përfshirë në projekt u vendosën kontakte dhe u zhvilluan takime për mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorit të përgatitur për këtë target grup. Në total u kontaktuan 70 agjenci private punësimi dhe biznese. Në këtë pjesë nuk do të bëjmë një ndarje të tyre sipas bashkive për shkak se mundësitë e punësimit që agjencitë dhe bizneset ofrojnë nuk lokalizohen ekskluzivisht vetëm në një bashki.

Figura e mëposhtme tregon grupmoshat që i drejtohen agjencive private, por edhe bizneseve për t'u punësuar.




Figura nr. 32: Grupmoshat që i drejtohen agjencive private të punësimit dhe bizneseve

Nga Figura i mësipërme vërehet se të rinjtë 15-18 vjeç nuk i drejtohen agjencive private të punësimit ose bizneseve.

Në lidhje me informacionin që zotërojnë agjencitë private të punësimit dhe bizneset për formimin profesional të punëkërkuarëve, rezultoi se 95% e subjekteve të anketuara zotërojnë një informacion të tillë.




Figura nr. 33: Informacioni mbi formimin profesional të punëkërkesve

Në vazhdim kur subjektet e anketura janë pyetur më në detaje nëse zotëronin informacion mbi një kategori të caktuar të punëkërkesve, konkretisht të diplomuarit në arsimin profesional. Agjencitë private të punësimit dhe bizneset janë shprehur në masën 70% se kanë informacion mbi të diplomuarit e arsimin profesional. Ndërkohë, që 30% e tyre nuk e zotëronte një informacion të tillë.

Të njëjtin trend ka ndjekur edhe përgjigja e tyre mbi aftësitë profesionale, që zotërojnë të diplomuarit në arsimin dhe formimin profesional për të siguruar një punë. Më konkretisht, 73% e të anketuarve janë përgjigjur se kjo kategori e punëkërkesve zotërojnë aftësi të duhura për të siguruar një punë, në raport me 27%, të cilët vlerësojnë të kundërtën.




Figura nr. 34: Zotërimi i aftësive të duhura profesionale për të siguruar punë

Nga të dhënat e pyetësorëve rezulton se agjencitë private të punësimit dhe bizneset në një masë prej 80% posedojnë të dhëna mbi Qendrat Private të Formimit Profesional, krahasuar me 20% prej

tyre të cilët nuk kishin dijeni mbi këto Qendra. Disa prej subjekteve të pyetura, pohuan se këto qendra i kanë kontaktuar për të lidhur ura bashkëpunimi mes tyre dhe ofruesve të punës.




Figura nr. 35: Informacioni mbi Qendrat Private të Formimit Profesional

Madje, nga agjencitë private të punësimit dhe biznesi rezultoi të kenë një vlerësim tepër pozitiv për Qendrat Private të Formimit Profesional, duke vlerësuar se formimi dhe kualifikimi në kurse profesionale afatshkurtra dhe/ose afatmesme është një input tepër pozitiv për karrierën e ardhshme të punëkërkesve, jo vetëm atyre të rinj, por edhe grupmoshave të tjera, të cilët mund të gjenden në stadi të ndryshme të karrierës, duke argumentuar se ndryshimi i nevojave të tregut të punës dhe i teknologjisë sjell një domosdoshmëri përmirësimi njohurish, qoftë edhe për persona të cilët kanë punuar në një profesion të caktuar prej vitesh. Konkretisht sikurse mund të vërehet nga Figura e mëposhtme, 80% e të anketuarve shprehën vlerësim pozitiv mbi dobinë e QFP-ve private.




Figura nr. 36: Dobishmëria e Qendrave Private të Formimit Profesional

Gjithashtu, përmes pyetësorëve gjeneruam informacion lidhur me profesionet, të cilat kanë më tepër vende të lira pune në treg sipas vlerësimit të sektorit privat.




Figura nr. 37: Vlerësimi për profesionet me vende më të lira pune në treg

Nga rezultatet e paraqitura në tabelë rezulton se profesionet kanë të njëjtin renditje përsa i përket vendeve të lira të punës. Ndërkohë, një ofertë disi më të lartë në masën 22% e ka profesioni i elektricitistit, i cili pasohet nga ai i hidraulikut dhe call center në masën 21% dhe i parafundit renditet profesioni i kamarierit në masën 19%. Ndërkohë, që nga përgjigjet e subjekteve të anketuara derivoi se profesioni ka një ofertë më të ulët të vendeve të lira të punës prej 17% është ai i punëtorit të thjeshtë.

Në përfundim, agjencitë private të punësimit dhe bizneset u pyetën mbi arsyet përse vlerësonin se profesionet e cituara kanë ofertën më të lartë të vendeve të punës në treg.




Figura nr. 38: Arsyet e ofertës së lartë të vendeve të lira të punës

Ndër arsyet e renditura në një pozicion të barabartë prej 40% qendron numri i ulët i punëkërkuësve për këto profesione, të cilat kanë ofertë të lartë vendesh të lira pune, ndjekur nga mungesa e kualifikimit të punëkërkuësve në lidhje me këto profesione. Një përqidje më të ulët prej 25% ze

niveli i ulët i pagesës, që përfitojnë punëmarrësit në këto profesione. Ndërsa, kushtet jo tërheqëse të punës dhe mungesa e prespektivës për karrierë në këto profesione zenë një hapësirë respektivisht prej 10% dhe 15% të përgjigjeve të target grupit të pyetur

VI. REKOMANDIMET

Në kuadër të këtij gjetjeve të këtij studimi vlerësojmë se duhen pasur në vëmendje rekomandimet e mëposhtme:

- ✓ MMSR nëpërmjet aktiviteteve të reformës së shërbimeve shoqërore, duhet të orientojë bashkitë drejt përfshirjes në planet vendore sociale dhe në buxhetet përkatëse të masave për të rritur aksesin e fëmijëve nga familje me të ardhura të ulta në arsimin dhe formimin profesional;
- ✓ Në planin individual të mbrojtjes nga trafikimi dhe shfrytëzimi duhet të përfshihet formimi profesional. Neni 61, pika 6 e Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcakton se *Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës harton Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, i cili përmban Masën e Mbrojtjes përkatëse, ndërhyrjet e nevojshme dhe shërbimet për të cilat ka nevojë fëmija, me qëllim trajtimin e tij në aspektin shëndetësor e psikoemocional si dhe rehabilitimin e riintegrimin e tij.*
- ✓ Në Planin e aftësimin Prindëror është e rëndësishme të përfshihet informacioni rreth aftësimin për punësim “skills for jobs”: Neni 63, pika 2/d i Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, përcakton si masë të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik dhe ndihmën që Punonjësi për Mbrojtjen e fëmijës mund t’i ofrojë familjes: d) ndihmën për aksesimin e tregut të punës; dh) çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme, e cila ndihmon në përmirësimin e situatës familjare, duke krijuar premisa për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi.
- ✓ Është e rëndësishme të përfshihet këshillimi për AFP ose punësim i familjes dhe/ose personit 16-18 vjeç në dosjen individuale të tyre.
- ✓ NjMF mund të referojë direkt pranë Qendrave të Formimit Profesional (publike ose private) dhe Zyrave Vendore të Punësimin, raste nevojë për formim profesional dhe punësim;
- ✓ NjMF të përfshijë Zyrat Vendore të Punësimin në grupin multidisiplinar për rastet e fëmijëve që kanë mbushur moshën për aftësimin profesional dhe/ose punësim dhe aftësimin për punë/punësimin e familjeve të tyre.
- ✓ Të merren si shembull dhe zbatohen praktikat pozitive të lehtësimin të punësimin, të aplikuar në Tiranë në nismën e mbrojtjes së fëmijëve në situatë rruge.
- ✓ Është e rëndësishme vendosja në dispozicion të NjMF-ve e informacionit mbi programet e formimit profesional dhe punësimin.

- ✓ Bashkitë në planet sociale të përfshijnë forma të tjera aftësimi punësimi, në bashkëpunim me organizata ose agjenci të specializuara për ofrim mikro-kredi për hapje biznesi, biznese sociale.
- ✓ Bashkitë të parashikojnë në buxhetin e tyre dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, duke u fokusuar vecanërisht te shtresat në nevojë. Një funksion i tillë i bashkisë buron nga Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 28.
- ✓ Sipas Ligjit Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, mund të mbështeten me bursa studimi në AFP studentë që u përkasin shtresave nevojë (Neni 32, paragrafi 2 i ligjit). Në përputhje me këtë nen, bashkitë mund të përkrahin fëmijët nga shtresat në nevojë për të përfituar nga programet e AFP-së nëpërmjet bursave. Për të siguruar një përshtatshmëri të profilit të kurseve me sektorë ekonomikë të zhvilluar ose të planifikuar për t’u zhvilluar në bashkinë përkatëse, Neni 32, paragrafi 3 i Ligjit përcakton se pushteti vendor mund të ofrojë bursa për të ndjekur AFP-në në bashki të tjera në profile që përputhen me prioritetet vendore, sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.

SHTOJCA I

Shkollat në të cilat u kryen anketimet dhe u mbajtën fushatat e informimit në pesë bashkitë e përzgjedhura për këtë projekt janë të listuara si më poshtë vijon.

1. Shkollat në qytetin e Tiranës⁷⁹

- Shkolla 9-vjeçare “Hasan Tahsin”
- Shkolla e mesme e përgjithshme “Ibrahim Rugova”
- Shkolla 9-vjeçare “Androkli Kostallari”
- Shkolla 9-vjeçare “Bajram Curri”
- Shkolla 9-vjeçare “Ramazan Jarani”
- Shkolla 9-vjeçare “Lazgush Poradeci”
- Shkolla 9-vjeçare “Ataturk”

2. Shkollat në qytetin e Elbasanit⁸⁰

- Shkolla 9-vjeçare “Europa”
- Shkolla 9-vjeçare “Luigj Gurakuqi”
- Shkolla 9-vjeçare “Fadil Gurmeni”
- Shkolla 9-vjeçare “Ali Agjahu”
- Shkolla 9-vjeçare “Jorgji Dilo”

3. Shkollat në qytetin e Fierit⁸¹

- Shkolla 9-vjeçare “Hasan Maneku”
- Shkolla 9-vjeçare “Mark Dashi”
- Shkolla 9-vjeçare “Liri Gero”
- Shkolla 9-vjeçare “Kristaq Shtembari”
- Shkolla 9-vjeçare “Penellopi Pirro”

4. Shkollat në qytetin e Shkodrës⁸²

- Shkolla 9-vjeçare “Abdyl Bajraktari”
- Shkolla 9-vjeçare “Vasil Shanto”
- Shkolla 9-vjeçare “Ali Leçaj”
- Shkolla 9-vjeçare “Gjon Ndoci”
- Shkolla 9-vjeçare “Oso Kuka”
- Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”
- Shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”

5. Shkollat në qytetin e Durrësit⁸³

- Shkolla 9-vjeçare “Hasan Koçi”
- Shkolla 9-vjeçare “14 Nëntori”
- Shkolla 9-vjeçare “Neim Babameto”

⁷⁹ Zonat periferike të Saukut, Kombinatit dhe në bashkinë Kamëz

⁸⁰ Katund i Ri

⁸¹ Patos

⁸² Vrakë, Bushat dhe bashkia e Koplikut

⁸³ Porto Romano dhe Shkozet

- Shkolla 9-vjeçare “Marie Kaçulini”
- Shkolla 9-vjeçare “Met Hasa”

SHTOJCA II

Qendrat e Formimit Profesional Publik⁸⁴ në pesë bashkitë e pëzgjedhura janë si më poshtë vijon:

1. DREJTORIA RAJONALE E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK - TIRANA NR. 1⁸⁵

Qendra e formimit profesional Nr. 1 në Tiranë ofron këto kurse:

- Gjuhë të huaja (anglisht, italisht, spanjisht, frengjisht)
- Sekretari
- Mekanik automjjetesh
- Elektroaut
- Instalime elektrike
- Stilim Rrobaqepësi
- Graphic Design
- Kondicionerë shtëpiakë
- Panele diellore
- Web Design
- Saldim
- Parukeri
- Estetikë
- Operator social
- Kujdestari fëmijësh
- Panele fotovoltaike
- Kompjuter
- Riparues dhe teknologji aparaturash mjeksore

2. DREJTORIA RAJONALE E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK - TIRANA NR. 4⁸⁶

Qendra e formimit profesional Nr. 4 në Tiranë ofron këto kurse:

Departamenti i Shërbimeve Teknike

- Hidraulik
- Rrobaqepësi
- Riparues i pajisjeve të tjera elektroshtëpiake
- Instalues dhe riparues i rrjetit elektrik, niv.1 & niv. 2 & niv. 3
- Riparues Elektronik për Radio & Tv
- Riparues elektronik për kompjutera

⁸⁴ http://www.vet.al/qendrat_formimit_profesional/publike

⁸⁵ <https://drfpp1.wordpress.com/>

⁸⁶ <http://drfpp4.al/>

- Graphic Desing
- Web Desing
- Instalues dhe Riparues të Sistemeve Ngrhëse-Ftohëse +(klima 50 orë)
- Instalues dhe riparues të Paneleve Diellore
- Instalues dhe Riparues të Paneleve Fotovoltaike
- Llamaniist & Bojatisje Automjeti
- Shërbime Automobiliste
- Elektroaut niv.1 & niv.2
- Saldator për Saldime me Hark Elektrik, Gaz, MIG-MAG-TIG
- Ndërtimtari (Murator, Suvatues, Montues i Sistemeve të Thata, Hidroizolues niv.1 & niv.2, Bojaxhi, Pllakashtrues, Karpentier, Hekur-Kthyes)
- Kopshtari
- Mobileri
- Punim druri
- Tapicier
- Punëtor Duro-alumini
- Parukeri
- Estetik & Kozmetik
- Berber
- Manikyr & Pedikyr
- Pilografi (shtypi, ofset-libërlidhja)
- Hekurpunues (punime artizanale)

Departamenti i Shërbimeve Turistike

- Kuzhinier niv. 1
- Kuzhinier niv. 2
- Banakier
- Kamarier
- Guidë turistike
- Turizëm familjar
- Receptionsist
- Departamenti i Shërbimeve Sociale
- Emërtimi i kursit
- Arkiv
- Protokoll
- Sekretari
- Kujdestar fëmijësh
- Shërbim shtëpie
- Kujdestar te kujdesit për persona me aftësi të kufizuar
- Asistent social

- Kujdestar i kujdesit për të moshuar
- Sipërmarrës dhe Manaxher i biznesit të vogël
- Arkëtar
- Animator social
- Administrator pallatesh

Departamenti i Shërbimeve Suplementare

- Përdorues kompjuteri
- Gjuhë Angleze
- Gjuhë Gjermane
- Gjuhë Italiane

3. DREJTORIA RAJONALE E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK - DURRËS⁸⁷

Qendra e formimit profesional Durrës ofron këto kurse:

Departamenti i Shërbimeve Teknike

- Elektroaut
- Shërbime automobilistike
- Llamanirist dhe Saldator
- Riparues i pajisjeve elektroshtëpuiake
- Instalues dhe riparues i paneleve fotovoltaike
- Hidraulikë
- Instalues dhe riparues i paneleve diellore
- Riparues i Pajisjeve Elektronike
- Riparues Elektronik për Kompjutera
- Ndërtimtari (Muratorë, Suvatorë, Pllakashtrues, hidroizolim bojatisje etj).
- Punëtor Duro-Alumin
- Riparim Makina Qepëse
- Qepje faqe këpucësh
- Kopështari-Lulishtari
- Punues Druri, mobilier, Tapicier
- Rrobaqepsi
- Modelim, Stilim
- Berber
- Parukeri Estetikë Qëndistari

Departamenti i Shërbimeve Turistike

- Pactiçier

⁸⁷ <https://www.facebook.com/Drejtoria-Rajonale-e-Formimit-Profesional-Publik-Durres-488053331321760/>

- Kuzhinier
- Kamarier
- Banakier
- Receptionsist Hoteli
- Turizëm Familjar
- Guidë Turistike

Departamenti i Shërbimeve Sociale

- Sekretari
- Asistente Sociale
- Kujdestar Fëmijësh
- Kujdestar të Kujdesit për personat me aftësi të kufizuar
- Arkëtar Zyre

Shërbime të tjera Suplementare

- Përdorues Kompjuteri
- Graphic Design
- Gjuhë Angleze
- Gjuhë Italiane
- Gjuhë Gjermane

4. DREJTORIA RAJONALE E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK – FIER⁸⁸

Qendra e formimit profesional në Fier ofron këto kurse:

- Arkëtar
- Murator
- Punues Druri
- Anglisht
- Italisht
- Riparim makinash qepëse
- Rrobaqepës
- Mek.Automjetesh
- Hidraulik
- Panele Diellore
- Sekretari
- Përdorim kompjuteri
- Operator social
- Kujdestar fëmijësh
- Instalime elektrike
- Parukier

⁸⁸ <https://www.facebook.com/Drejtoria-Rajonale-e-Formimit-Profesional-Publik-Fier-501921633268508/>

- Estetikë-kozmetik
- Saldim
- Kuzhinë
- Riparim pajisjesh elektroshtëpiake
- Riparim kompjuteri
- Berber

Kurse që mund të hapen gjatë muajit mars-prill 2017

- Suvatues
- Pllakashtrues
- Qendistari
- Banakier
- Guide turistike
- Drejtues në hotele dhe restorante
- Receptionsist –hotele
- Sipërmarrje në fushën e turizmit
- Mirembajtës bujtine (punëtor shërbimi në hotele)
- Teknik ashensorësh
- Marangoz
- Tapicier

5. DREJTORIA RAJONALE E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK – SHKODËR⁸⁹

Qendra e formimit profesional në Shkodër ofron këto kurse:

- Sektretari
- Panele fotovoltaike
- Instalues e riparues rrjeti elektrik
- Rrobaqepsi
- Elektroshtëpiake (sipas niveleve)
- Instalues e riparues panele diellore
- Instalues e riparim sisteme ngrohëse ftohëse
- Hidraulike (sipas nivele)
- Qendistari
- Kuzhinë
- Parukieri
- Estetiste
- Saldator
- Kamarier
- Banakier
- Teknik ashensorash

⁸⁹<https://www.facebook.com/Drejtoria-Rajonale-e-Formimit-Profesional-Publik-Shkoder-291377181042337/>

- Rrobaqepsi industriale
- Mekanik i përgjithshëm
- Instalues dhe riparues kondicionerash
- Mobilier
- Tapicier
- Person që shet me telefon
- Pasticier dhe të tjerë të ngjashëm me to
- Artizan punime kashte
- Gdhëndës druri
- Mekanik automobilash
- Suvatues
- Receptionsist ne hotele
- Mekanik për makina industriale (qepëse)
- Sipërmarrës
- Artizan punime tekstili
- Guide turistike
- Elektroauto
- Punëtor qepje faqe këpucë
- Punime qilimash
- Kopshtar
- Berber
- Anglisht
- Italisht
- Kompjuter

Qendra e formimit profesional në Shkodër ofron këto kurse në ambientet e jashtme të biznesit:

- Punime artizanati (Qilima, punime të thurura, qendistari, punime druri)
- Telemarketing
- Rrobaqepsi industriale
- Qepje faqe këpucë
- Saldator
- Kamarier
- Banakier
- Kuzhunier
- Asistent i kujdesit shëndetësor
- Punime hekuri dekorativ
- Parukieri
- Estetike
- Berber
- Mekanik automobilash

- Elektroauto
- Guidë turistike
- Bazat e sipërmarrjes

Kurse që mund të hapen gjatë muajit mars - prill 2017

- Pllakashtrues
- Qendistari
- Drejtues në hotele dhe restorante
- Receptionsist - hoteli
- Sipërmarrje në fushën e turizmit
- Mirembajtës bujtine (punëtor shërbimi në hotele)
- Marangoz

DREJTORIA RAJONALE E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK - ELBASAN⁹⁰

- *Qendra e formimit profesional Elbasan ofron këto kurse:Gjuhë të huaja (anglisht, italisht, gjermanisht)*
- Sekretari
- Kompjuter
- Rrobaqepësi
- Qëndistari
- Instalime elektrike
- Hidraulik

⁹⁰ <http://qfp-elbasan.vet.al/>

BIBLIOGRAFIA

Legjislacion:

Ligji nr. 8417, dt. 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar.
Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë, ndryshuar.
Ligj nr. 18/2017, datë 23.02.2017, Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
Ligji nr. 15/2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional” në Republikën e Shqipërisë
Council of Europe Convention on action against trafficking in Human Beings, Warshaw, 16 May 2015
Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948.
Konventa e Këshillit të Evropës për Ndërmarrjen e Masave Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.
Supplementing Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons Especially Women and Children.
United Nations Convention against Transnational Crime.

Dokumenta politikë:

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2013). *Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi (2014-2020)*.
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2015). *Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020*.
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2016). *Përfshirja Sociale, Dokumenti Politik 2016-2020*.
Ministria e Punëve të Brendshme. (2014). *Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014-2017*.
Plani Kombëtar i Veprimit "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017". Raport vjetor korrik 2015 – qershor 2016.
Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 9 nëntor 2016
Trafficking in Persons Report- Departament of State, June 2016

Tekste dhe Artikuj:

From education to working life. The labour market outcomes of vocational and training, Luksemburg, 2012,
British Council.(2016). *Udhëzues mbi angazhimin e punëdhënësve*.
European Commission.(2010). *Communication from the Commission to the European Parliament, to the Council, the European Economic and Social Committee and Committee of the Regions*.
GIZ/ETF. (2014). *Studimi Bazë i Ofruesve Publik të AFP-së në Shqipëri*.
Halvorsen, K. “Notes on the realization of the Human Right to Education”, Human Rights Quarterly, Vol. 12, No. 3.
Kore, Z. & Lenja, V. (2017). *Masat për mbrojtjen e fëmijëve*. Tiranë: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.
Pepa, A. et.al.(2016). “Skills for Jobs”, Research Report. Tirana: Swisscontact.

Simoni, S. (2013). *Kuadri ligjor mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore*: “Trajtimi i viktimave të trafikimit si dëshimitar gjatë procesit gjyqësor. Mundësit ligjore për kompesimin e viktimave të trafikimit dhe nevojapër ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën ligjore”. Tiranë: Shkolla e Magjistraturës.

Webografi:

<https://www.unicef.org/malaysia/1959-Declaration-of-the-Rights-of-the-Child.pdf>

[http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Unemployment_statistics#Youth_unemployment_trends)

[explained/index.php/Unemployment_statistics#Youth_unemployment_trends](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Unemployment_statistics#Youth_unemployment_trends)

http://erasmusplus.al/?page_id=2891

<http://gpseducation.oecd.org/CountryProfile?primaryCountry=ALB&treshold=10&topic=PI>

[http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryIDç2&LangçE](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryIDç2&LangçEN)
[N](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryIDç2&LangçEN)

<http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx>

<http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx>

<http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx>

<http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-pun%C3%ABs.aspx?tab=tabs->

[5http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx](http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx), Shifrat, Popullsia 1 janar 2001-2017, t 1,

http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf

http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf,

http://www.vet.al/qendrat_formimit_profesional

<https://al.usembassy.gov/sq/education-culture-sq/educational-exchange-programs-sq/>

https://www.unicef.org/albania/sq/children_27590.html

<https://www.unicef.org/malaysia/1959-Declaration-of-the-Rights-of-the-Child.pdf>